


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

UDHËZUES KURRIKULAR
(MATERIAL NDIHMËS PËR MËSUESIT E GJIMNAZIT)

FUSHA : TEKNOLOGJIA



TIRANË, 2010

AUTOR:

TEKNOLOGJIA:
MSC. EDLIRA SINA
ING. ALQI MUSTAFAI
ING. ROBERT TYTYMÇE
MAJLINDA LIPO
PETRINA BLUSHI

TIK:
ERION SELIMI
ANDI ABDULLARI
BLERTA BALA



Udhëzuesi kurrikular i Teknologjisë për klasën e dymbëdhjetë të gjimnazit është një material ndihmës për përdoruesit e kurrikulës, dhe veçanërisht për mësuesit.

Ky udhëzues ndihmon përdoruesit në zbatimin e programit mësimor të kësaj lënde dhe sugjeron metoda të suksesshme të mësimdhënies, të nxënit, vlerësimit dhe vetëvlerësimit të nxënësve.

PËRMBAJTJA

1. RËNDËSIA E LËNDËS TEKNOLOGJIA NË KURRIKULËN E RE PËR NXËNËSIT

1.1 Synimet e kurrikulës së re

1.2 Terminologjia kyç dhe konceptet

1.3 Fusha dhe përmbajtja

1.4 Integrimi i teknologjisë brenda fushës, si dhe me lëndët e tjera të kurrikulës bërthamë

1.5 Objektivat e arritjes për klasën e 12-të

1.6 Zbërthimi i objektivave të programit në objektiva specifike sipas niveleve të arritjes nga nxënësit

2. METODOLOGJIA DHE MJETET MËSIMORE PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS

3. VLERËSIMI I NXËNËSIT

4. ORË MËSIMI MODEL

PJESA PARË

1. RËNDËSIA E LËNDËS TEKNOLOGJIA NË KRRIKULËN E RE PËR NXËNËSIT

Edukimi Teknologjik është një komponent thelbësor i kurrikulit. Në një botë, ku ndeshesh me shumë lloje teknologjish, të cilat janë pjesë e jetës së përditshme për të gjithë njerëzit gjatë punës ose kohës së lirë, nxënësit duhet të pajisen me aftësi për t'u përballur me to me vetëbesim. Është po aq e rëndësishme që nxënësit të vlerësojnë dhe kuptojnë marrëdhënien komplekse ndërmjet teknologjisë dhe shoqërisë. Si qytetarë, ata duhet të kenë kapacitetin për të diskutuar dhe për të bërë gjykime vetjake mbi çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetët e tyre, në shoqëri dhe në mjedis.

Nëpërmjet edukimit teknologjik, nxënësit shtojnë kompetencën, vetëbesimin, bëhen më me iniciativë dhe zhvillojnë aftësi për të kontrolluar elementet e mjedisit fizik. Këto janë rezultate të pritshme të rëndësishme, të cilat kontribuojnë mjaft në hartimin e një kurrikuli të gjerë dhe të balancuar dhe ilustrojnë faktin që pjesëmarrja në edukimin teknologjik përbën një përvojë të vlefshme shkollimi.

Teknologjia është një formë e veçantë e veprimtarisë krijuese, ku njerëzit ndërveprojnë me mjediset e tyre, duke përdorur materialet dhe proceset e duhura në përgjigje të nevojave, dëshirave dhe mundësive të tyre. Ajo integron aftësitë për zgjidhje problemi dhe ato praktike në prodhimin e produkteve dhe sistemeve të dobishme.

Në mënyrë më specifike, vlera e edukimit teknologjik vjen nga përdorimi i një grupi të gjerë aftësish të nevojshme për projektimin apo prodhimin e një produkti, duke çuar në zhvillimin e kompetencës dhe ndjesisë së mundësive vetjake për t'i zbatuar këto aftësi. Fitimi i aftësive manipulative (përpunuese) përbën një komponent të rëndësishëm për zhvillimin e kompetencës dhe i ndihmon nxënësit të kenë ndjesinë e kontrollit ndaj mjedisit të tyre fizik. Një shoqëri globale e në ndryshim të shpejtë kërkon që nxënësit të vlerësojnë nevojën dhe domosdoshmërinë e kapacitetit teknologjik, për të gjitha aspektet e jetës dhe punës. Shumë nga lëndët kontribuojnë në zhvillimin e kapacitetit teknologjik. Pikërisht, lëndët e teknologjisë, janë bazë e këtij zhvillimi pasi ato përshkohen nga parimet e projektimit dhe realizimit të një produkti në mënyrë krijuese.

1.1 Synimet e kurrikulës së re

Programi i lëndës Teknologji synon: Pajisjen e nxënësve me njohuri, aftësi dhe teknika më të konsoliduara e zgjeruara dhe të një niveli më të lartë se sa ato të fituara më parë, të cilat janë bazë për një arsimim të lartë universitar. **Programi përmban linjat kurrikulare bërthamë të studimit, të detyrueshme për të gjithë nxënësit.**

Kurrikula e Teknologjisë së gjimnazit synon:

- **të kontribuojë** në një edukim të balancuar, duke iu dhënë nxënësve një përvojë të gjerë dhe sfiduese, që do t'u krijojë mundësi atyre të fitojnë një grup njohurish, kuptimesh, aftësish njohëse e manipuluese dhe kompetenca, duke i përgatitur në këtë mënyrë që të jenë pjesëmarrës krijues në një botë teknologjike;

- **t'u krijojë mundësi** nxënësve të integrojnë këto njohuri dhe shkathtësi/shprehi, së bashku me cilësitë për hulumtim dhe mendim reflektiv, për gjetjen e zgjidhjeve për problemet teknologjike, me vëmendjen e duhur ndaj çështjeve të sigurisë dhe ruajtjes së mjedisit;

- **të lehtësojë zhvillimin e një sërë aftësive të komunikimit**, që do t'i nxisin nxënësit të shprehin aftësitë e tyre krijuese në mënyrë praktike dhe me imagjinatë, duke përdorur shumëllojshmëri formash: fjalët, grafikët, modelet etj;

- **të sigurojë një kontekst**, në të cilin nxënësit mund të zbulojnë dhe vlerësojnë ndikimin e teknologjive në ekonomi, në shoqëri dhe në mjedis në të kaluarën, në të tashmen dhe në të ardhmen.

Programi i teknologjisë është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare. Ai është hartuar dhe mbështetur në dokumentet kryesore, si korniza kurrikulare e gjimnazit dhe standardet e fushës, ku kjo lëndë bën pjesë.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- Synimeve të përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit.
- Synimeve të linjave ndërkurrikulare.

- Vlerësimet të nxënësit.
- Parimeve të mësimdhënie mësimnxënies.

Përdoruesve të këtyre dokumenteve u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënësve dhe të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare.

Çdo standard i fushës në këtë dokument përmban një seri linjash dhe standarde të linjave.

Linjat janë drejtime në të cilat përmbushet standardi.

Standardi i linjës është një pohim specifik që tregon atë që nxënësit duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë në një drejtim të caktuar specifik të standardit të përgjithshëm. Standardet e linjës shërbejnë për të matur progresin e nxënësve drejt arritjes së standardit të përgjithshëm. Sikurse dhe standardi i përgjithshëm, edhe standardi i linjës është përcaktuar për në fund të gjimnazit.

Për çdo standard linje janë vendosur një seri objektivash arritjeje.

Objektivat e arritjeve janë pohime të njohurive, aftësive, qëndrimeve që nxënësi demonstron në përpjekjen për të arritur standardin e linjës.

1.2 Terminologjia kyç dhe konceptet

Programi i teknologjisë për klasën e 12-të të gjimnazit është organizuar me linja dhe nënlinja. Për çdo nënlinjë shënohen objektivat, të cilët materializojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që pritet të nxënë nxënësit gjatë këtij kursi.

Konceptet kryesore që do të trajtohen përmes përmbajtjes së këtij programi, përqendrohen dhe mbushin linjat e këtij programi mësimor, të cilat janë:

Linja 1: Teknologjia dhe sistemet teknologjike

Linja 2: Komunikimi grafik

Linja 3: Materialet teknologjike

Linja 4: Strukturat dhe mekanizmat

Linja 5: Teknologjia e prodhimit

Linja 6: Teknologjia e shërbimeve

Zhvillimi i aftësive

Aftësitë teknologjike përfshijnë:

- të kuptuarit e koncepteve dhe proceseve të duhura;
- shkathësitë e shprehite për projektim dhe realizim;
- aftësinë për zbatimin e njohurive dhe shkathësi/shprehive duke menduar dhe vepruar me vetëbesim, me imagjinatë, në mënyrë krijuese dhe me ndjeshmëri;
- aftësinë për vlerësimin kritik dhe konstruktiv (dobiprurës) të veprimtarive, produkteve dhe sistemeve teknologjike.

Qëllimet dhe parimet:

- Qëllimi i përgjithshëm i arsimit është të kontribuojë për zhvillimin e të gjitha aspekteve të individit, përfshi atë estetik, krijues, kritik, kulturor, emocional, shprehës, intelektual, për jetën personale dhe familjare, për jetën në punë, për jetën në komunitet dhe për kohën e lirë.
- Programi është konceptuar brenda këtij qëllimi të përgjithshëm, me theks të veçantë në përgatitjen e nxënësve me kërkesat për shkollim ose formim të mëtejshëm, për punë dhe për rolin e tyre si qytetarë pjesëmarrës dhe me iniciativë.
- Programi synon të sigurojë vazhdimësi dhe avancim të programit të arsimit të mesëm të ulët. Pësia e dhënë komponentëve të ndryshëm, si zhvillimit vetjak dhe social, studimit të përmbajtjes profesionale, përgatitjes për shkollim të mëtejshëm dhe për jetën si i rritur e në punë brenda programit mund të jetë e ndryshme.
- Programi kontribuon në:
 - të nxënit individual dhe mendimin e pavarur;
 - shpirtin kërkues, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemit, vetë besimin, iniciativën dhe sipërmarrjen;
 - përgatitjen për shkollim të mëtejshëm, për jetën si i rritur dhe jetën në punë;
 - të nxënit gjatë gjithë jetës.

Kurrikula e gjimnazit në përgjithësi dhe ajo e teknologjisë në veçanti përshkohet nga disa linja ndërkurrikulare.

Këto linja ndërkurrikulare ndahen në tri grupime:

- A. të përmbajtjes;**
- B. të menduarit;**
- C. të qëndrimit.**

A. Linjat ndërkurrikulare të përmbajtjes janë:

teknologjia e informacionit dhe e komunikimit dhe komunikimi.

Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit - TIK

Secili nxënës të bëhet i aftë që lehtësisht dhe në mënyrë organike, në çfarëdo situatë që i paraqitet në lëndën e teknologjisë:

- të kërkojë e të gjejë informacion elektronik;
- të hetojë, të bëjë parashikime dhe të zgjidhë situata problemore me ndihmën e mjeteve elektronike;
- të paraqesë e prezantojë punën tij duke përdorur një larmi mediash dixhitale;
- të bashkëpunojë me bashkënxënësit nëpërmjet komunikimit elektronik.

Komunikimi: nxënësit ushtrohen të komunikojnë me shkrim të zakonshëm, me anën e figurave dhe të përdorin mjete të ndryshme të komunikimit, përfshirë dhe ato multimediatike.

Katër format e komunikimit janë: *me të folur, me të dëgjuar, me lexim, me shkrim.*

E folura

Secili të bëhet i aftë t' u transmetojë me gojë të tjerëve informacione, ide dhe imazhe në mënyrë të saktë, të qartë, të plotë, të mirëstrukturuar dhe bindëse, duke përdorur: *një fjalor gjithnjë e më të pasur dhe mënyrën më të përshtatshme për një audiençë të caktuar dhe situatë të caktuar.*

E dëgjuara

Secili të bëhet i aftë:

- të jetë dëgjues i vëmendshëm;
- të veçojë qartë paqartësitë që i dalin nga dëgjimi i parashtrimeve të tjerëve;
- t'i bëjë pyetje folësit për paqartësitë e tij;
- t'i bëjë komente rreth parashtrimeve të tjerëve.

Të lexuarit

Secili të bëhet i aftë:

- të lexojë me shpejtësinë dhe saktësinë e mjaftueshme për të kuptuar një tekst;
- të veçojë qartë moskuptimet që i dalin gjatë leximit;
- të përdorë strategji të larmishme dhe të përshtatshme për të kuptuar, përdorur dhe reflektuar mbi një tekst të shkruar.

Të shkruarit

Secili të bëhet i aftë t'u transmetojë me shkrim të tjerëve informacione, ide dhe imazhe në mënyrë të saktë, të qartë, të plotë, të mirëstrukturuar dhe bindëse, duke përdorur: *një fjalor gjithnjë e më të pasur, larmi mënyrash të parashtrimeve me shkrim, si dhe mënyrën më të përshtatshme të komunikimit me shkrim për lexues të caktuar dhe situatë të caktuar.*

Linjat ndërkurrikulare të të menduarit janë:

- manaxhimi i informacionit;
- zgjidhja e situatave problemore;
- të menduarit kritik;
- të menduarit krijues.

Të tria këto linja janë të ndërlidhura dhe formojnë në të vërtetë një unitet që ka të bëjë me standardet intelektuale.

Manaxhimi i informacionit

Si në të gjitha fushat e të nxënit edhe në lëndën teknologji mësuesit duhet t'i japin mundësinë secilit nxënës që të stërvitet në kërkimin dhe përpunimin e informacionit, i cili i nevojitet që të përmbushë një detyrë të ndërmarrë nga ai vetë ose të ngarkuar nga të tjerë. (Detyra mund të jetë një pyetje deri në një projekt kompleks)

Secili të bëhet i aftë:

- të kërkojë në burime të larmishme informacioni për të përmbushur një detyrë;
- të pikasë burimin ose burimet më të përshtatshme të informacionit për të përmbushur një detyrë;
- të përdorë strategji të larmishme për të analizuar informacionin;
- të përdorë strategji të larmishme për të përpunuar informacionin;
- të vlerësojë informacionet nga pikëpamja e dobisë për detyrën dhe e vërtetësisë;
- të përdorë strategji të larmishme për të integruar informacionet nga burime të ndryshme;
- të veçojë me kthjelltësi çfarë kupton nga çka nuk kupton në informacionin që përpunon dhe të formulojë pyetjet për të qartësuar të kuptuarit;
- të përdorë strategji të larmishme për të nxjerrë shënimet e nevojshme nga informacioni i qëmtuar;
- të ruajë informacionin me mënyra të larmishme;
- të prezantojë informacionin e përpunuar me anën e një larmie formash dhe mjetesh.

Zgjidhja e situatave problemore

Të zgjidhësh një situatë problemore do të thotë të përdorësh njohuritë e fituara tanimë për të zgjidhur një problem në një situatë të pahasur më parë nga personi që merret me zgjidhjen.

Secili të bëhet i aftë:

- të analizojë një situatë problemore;
- të hartojë një plan për zgjidhjen duke e ndarë një detyrë në nën-detyra;
- të veçojë sistematikisht paqartësitë e të formulojë pyetje për to;

- të monitorojë dhe vlerësojë ecurinë e etapave të zgjidhjes problemore;
- të përdorë strategji të larmishme, si analogjinë, induksionin etj.;
- të justifikojë në mënyrë bindëse metodën ose metodat e përdorura të kërkimit dhe të arritjes së përfundimeve;
- të bëjë parashikime, të ngrejë hipoteza;
- të mbrojë ose hedhë poshtë parashikimet ose hipotezat me prova të mjaftueshme;
- të hetojë lidhjet “shkakpasojë”;
- të kërkojë e gjejë zgjidhje të ndryshme;
- të vlerësojë rrugën e zgjidhjes për ta përmirësuar atë.

Të menduarit kritik (të menduarit analitik)

Në përdorimin e përditshëm, termi “kritik” ka ngjyresën e një qëndrimi mosmiratues, kurse këtu, në të vërtetë, është fjala për të menduarit analitik. Si i tillë përfshin analizën, sintezën dhe vlerësimin si procese mendore tipike.

Të menduarit kritik është një strategji, e cila funksionon mirë kur duhet të përballemi me një situatë problemore ose të marrim një vendim.

Procesi i të menduarit kritik përmban grumbullimin e informacionit të nevojshëm, vlerësimin e tij dhe arritjen në një përfundim të mirargumentuar.

Pjesë e rëndësishme e të menduarit kritik është kujdesi i posaçëm i përhershëm ndaj paragjyqimeve vetjake ose të të tjerëve, anësisë, keqinformimit.

Mësuesit duhet t’i japin mundësinë secilit nxënës që të kultivojë të menduarit kritik (analitik) ndaj informacioneve, ngjarjeve, dukurive dhe qëndrimeve.

Secili të bëhet i aftë:

- të shqyrtojë opsione të ndryshme “pro” dhe “kundër” për një çështje të caktuar;
- të dallojë faktet nga interpretimet e tyre;
- të mbajë qëndrim të pavarur dhe argumentues ndaj gjyqimeve dhe qëndrimeve të të tjerëve;
- të mbajë qëndrim të pavarur dhe argumentues ndaj informacioneve

në përgjithësi dhe atyre mediatike në veçanti;

- të jetë i vemendshëm ndaj argumenteve të tjerëve dhe të mos i kundërvihet me paragjykime;
- të sjellë argumente dhe dëshmi për të mbështetur përfundimet, përgjithësimet dhe bindjet e tij;

Të menduarit krijues

Mësuesit duhet t'i japin mundësinë secilit nxënës që të shfaqë origjinalitetin e tij dhe të zhvillojë prirjet e veta krijuese.

Secili të bëhet i aftë:

- të shprehë nëpërmjet një larmie formash anët origjinale të personalitetit të tij në shkollë, komunitet dhe punë;
- të kërkojë për ide e rrugëzgjdhje të reja;
- të mirëpresë ide dhe përvoja të reja të tjerëve;
- të sipërmarrë me kurajo plane ambicioze duke analizuar shanset dhe marrë parasysh rreziqet.

Linjat ndërkurrikulare të qëndrimit janë: *qëndrimi etiko-social, qëndrimet gjatë punës në grup.*

Qëndrimi etiko - social

Përtej njohurive dhe aftësive dhe nëpërmjet tyre, edhe lënda aftësi për jetën synon një ndikim të fortë në formimin e karakterit të nxënësve, duke u përqendruar posaçërisht në rrënjosjen e qëndrimeve, vlerave dhe bindjeve vetjake. Gama e tyre është shumë e gjerë dhe përfshin, ndër të tjera, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të nxënësve në veçanti, pra, edhe mospranimin dhe mosushtrimin e çfarëdolloj diskriminimi, respektimit e vlerave, madje zhvillimin e tyre, mbrojtjen e mjedisit në gjithë larminë e tij etj.

Mësuesit duhet t'i japin mundësinë secilit nxënës që të ushtrohet për të mbajtur qëndrim etiko-social ndaj ngjarjeve, dukurive dhe qëndrimeve.

Secili të bëhet i aftë:

- të vlerësojë dukuritë, ngjarjet, qëndrimet dhe veprimet e tjerëve në të shkuarën dhe në të tashmen nga pikëvështrimi i dobisë sociale

për komunitetin, vendin, rajonin dhe më gjerë;

- të jetë pjesëmarrës aktiv i veprimtarive dhe i lëvizjeve, të cilat synojnë përmirësime në shkallë komuniteti, vendi, rajoni dhe më gjerë.

Qëndrimi gjatë punës në grup

Mësuesit duhet t'i japin mundësinë secilit nxënës që të përvetësojë qëndrimet e përshtatshme për punë të suksesshme në grup.

Secili të bëhet i aftë:

- të mbajë përgjegjësi ndaj suksesit të grupit të punës në tërësi;
- të respektojë rregullat e grupit të punës ku pranon të marrë pjesë;
- të jetë bashkëpunues me pjesëtarët e tjerë të një grupi pune;
- t'u përshtatet roleve të ndryshme brenda grupit;
- të sillet me respekt ndaj pjesëtarëve të tjerë të një grupi pune;
- të respektojë pikëpamjet e ndryshme të anëtarëve të grupit.

Në programin e ri të teknologjisë shprehen në mënyrë të dukshme **aftësitë, shprehitë dhe qëndrimet**, duke vënë theksin te rezultatet e të nxënësit.

Mësuesit duhet të organizojnë mësimdhënien në mënyrë të tillë, që nxënësit të zhvillojnë aftësitë dhe qëndrimet, si: *ato të të pyeturit, të krahasuarit, të renditurit, përpunimi i rezultateve, lidhja shkak-pasojë, parashikimi, komunikimi, hipoteza, interpretimi i të dhënave, lidhja e shkencës me jetën e përditshme, interesat, puna në grup etj.*

Të mësosh nxënësit që të mendojnë në mënyrë kritike do të thotë:

- T'i mësosh ata si të pyesin, kur të pyesin dhe çfarë pyetjesh të bëjnë (drejtojnë).
- T'i mësosh si të arsyetojnë, dhe çfarë metodash arsyetimi të përdorin.

Nxënësi mund të mendojë në mënyrë kritike dhe arsyetuese vetëm në masën që është në gjendje të shqyrtojë me kujdes përvojat, të vlerësojë njohuritë dhe idetë, dhe pastaj të peshojë argumentet përpara se sa të arrijë në një gjykim të balancuar. Të jesh mendimtar kritik përfshin, gjithashtu, zhvillimin e disa qëndrimeve të caktuara, si për shembull, dëshira për të arsyetuar, vullneti për të sfiduar dhe pasioni për të vërtetën.

Tipari dallues i të menduarit kritik është *gatishmëria për të sfiduar idetë e të tjerëve*. Një rrjedhim i kësaj është veçoria që nxënësi duhet të jetë gjithashtu i gatshëm që edhe idetë e veta t'ia nënshtrojë shqyrtimit të imët dhe sfidës së arsytimit. Kur i mëson nxënësit të mendojnë, një nga sfidat është që, ata të ndihmohen të zbulojnë procesin e vlerësimit; miratimi dhe mosmiratimi i ideve të vetes është një proces i natyrshëm dhe i shëndoshë; besimi për të qenë vetëkritik mund të forcojë kuptimin e vetvetes.

Më poshtë jepen disa modele që nxisin te nxënësit formimin e aftësive, si: *kompetencat, të menduarit kritik, krijues, qëndrimet dhe krijimtarinë*.

1.3 Fusha dhe përmbajtja

► Struktura

Kurrikula e gjimnazit përbëhet nga nëntë fusha të të nxënit, të cilat të renditura sipas alfabetit janë:

1. ARTET
2. EDUKIMI FIZIK DHE SPORTET
3. GJUHA E HUAJ
4. GJUHA SHQIPE
5. KARRIERA DHE AFTËSIMI PËR JETËN
6. MATEMATIKA
7. TEKNOLOGJIA
8. SHKENCAT NATYRORE
9. SHKENCAT SHOQËRORE

Secila *fushë kurrikulare* realizohet nëpërmjet *kurrikulës-bërthamë* dhe asaj me zgjedhje. Fushat lëndore në kurrikulën bërthamë përfaqësohen nga lëndët përkatëse. Të gjitha lëndët-bërthamë janë të detyrueshme për t'u ndjekur nga secili nxënës. Lëndët për çdo fushë të nxëni, për kurrikulën bërthamë, kurrikulën me zgjedhje të detyruar dhe propozimet për kurrikulën në bazë shkolle.

Kurrikula me zgjedhje është organizuar në kurrikulën me ***zgjedhje të detyruar*** dhe kurrikulën me ***zgjedhje të lirë***.

a) ***Kurrikula me zgjedhje të detyruar***, zhvillohet përmes ***lëndëve*** dhe ***moduleve lëndore*** si pjesë që ofrohen nga shteti dhe mundësojnë thellimin dhe zgjerimin e njohurive, aftësive, kompetencave të nxënësve në drejtime të parapëlqyera nga ata për t'u specializuar, të cilat shkolla i ofron dhe nxënësi zgjedh mes tyre.

b) ***Kurrikula me zgjedhje të lirë***, e thënë ndryshe ***kurrikula në bazë shkolle*** përfaqëson kurrikulën që vetë shkolla planifikon për nxënësit e saj, në përputhje me nevojat e aktualitetit dhe dëshirat individuale të nxënësve.

Kurrikula e gjimnazit e përcjell si kërkesë për këtë tip kurrikule planifikimin nga shkollat për secilin nxënës të një minimumi të detyrueshëm orësh për:

- shërbimin komunitar;
- projekteve kurrikulare të fushave të të nxënit;
- moduleve profesionale.

Përsa i përket lëndës së kurrikulës së teknologjisë, ajo është lëndë e detyrueshme në kurrikulën bërthamë (**KB^{1*}**) të gjimnazit.

Kjo lëndë studiohet përgjatë **34 javëve** mësimore të vitit shkollor. Programi i teknologjisë është hartuar mbi bazën e objektivave, të cilët përcaktojnë konceptet kryesore (njohuri, aftësi, qëndrime) që synojnë këto objektiva.

Kjo lëndë për të gjithë të interesuarit e edukimit, si dhe të gjitha lëndët që zhvillohen në kurrikulën bërthamë ka një kod që është përgatitur në kopertinën e çdo programi dhe që përfaqëson çdo lëndë në planin mësimor. Ajo është:

FUSHA: TEKNOLOGJI

LËNDA: TEKNOLOGJI

KODI: 9.2.12.B

*KB - kurrikula bërthamë, që ka të bëjë me lëndët e detyrueshme për të gjithë nxënësit që studiojnë në gjimnaz; KZGJD - kurrikula me zgjedhje të detyruar, që ka të bëjë me lëndët që nxënësit janë të detyruar të zgjedhin; KZGJL – kurrikul me zgjedhje të lirë, që ka të bëjë me lëndët që zgjedh nxënësi sipas parapëlqimeve, aftësive dhe synimeve që ka për të vazhduar shkollimin apo punësimin në jetë.

Programi i teknologjisë për gjimnazin është strukturuar në gjashtë linja që vijnë njëra pas tjetrës, që do të thotë se mësimdhënia mësimnxënia duhet të zhvillohet në këtë renditje përgjatë vitit shkollor.

Linja	Nr.orëve/ linjë	Linja
1.		Teknologjia dhe sistemet teknologjike
2.		Komunikimi grafik
3.		Materialet teknologjike
4.		Strukturat dhe mekanizmat
5.		Teknologjia e prodhimit
6.		Teknologjia e shërbimeve
Totali		

E gjithë struktura që ndjekin programet në tërësi të kurrikulës bërthamë është unike.

Formati i programit është:

1. Synimi i lëndës.
2. Objektivat e përgjithshëm.
3. Objektivat sipas linjave (janë 6 linja) dhe orët në total për zhvillimin e kësaj lënde.
4. Kërkesa të teknologjisë ndaj lëndëve të tjera.
5. Kërkesa për zbatimin e programit.
6. Vlerësimi.

Të gjitha rubrikat japin një panoramë të qartë të zhvillimit të përmbajtjes së kësaj lënde.

► Përmbajtja

Çdo linjë ka llojet e mëposhtme të përmbajtjes së saj:

Linja 1: Teknologjia dhe sistemet teknologjike. Kjo linjë ka për qëllim t'u ofrojë nxënësve njohuritë kryesore për teknologjinë dhe sistemet teknologjike, për t'i bërë të aftë të analizojnë marrëdhëniet e tyre dhe të shoqërisë me teknologjinë dhe mjedisin, të përshkruajnë procedura teknologjike të bazuara në problemzgjidhjen.

Linja 2: Komunikimi grafik. Kjo linjë i njeh nxënësit me mënyrat kryesore të komunikimit grafik, të cilat përbëjnë gjuhën bazë të teknologjisë, duke paraqitur nëpërmjet skicimit objekte të thjeshta teknike, mendimet dhe idetë e tyre, si edhe të lexojnë paraqitje grafike të thjeshta dhe të vështirësisë mesatare.

Linja 3: Materialet teknologjike. Kjo linjë i njeh nxënësit me kuptimin e konceptit “material teknologjik”, me llojet dhe vetitë teknologjike të grupeve kryesore të materialeve teknologjike, si dhe i aftëson ata të analizojnë përdorimet e materialeve teknologjike në teknologjinë e sotme.

Linja 4: Strukturat dhe mekanizmat. Kjo linjë i njeh nxënësit i me kuptimin e koncepteve që lidhen me strukturat dhe mekanizmat teknologjike, me klasifikimin e tyre dhe përdorimet e tyre, si dhe i aftëson ata të analizojnë ndërtimin dhe funksionimin e strukturave dhe mekanizmave teknologjike të sotme.

Linja 5: Teknologjia e prodhimit. Kjo linjë i njeh nxënësit me kuptimin e konceptit “teknologji prodhimi”, me llojet dhe grupet kryesore, si dhe i aftëson ata të analizojnë përdorimet e teknologjive të prodhimit në shoqërinë e sotme.

Linja 6: Teknologjia e shërbimeve. Kjo linjë i njeh nxënësit me kuptimin e konceptit “teknologji shërbimi”, me llojet dhe grupet kryesore, si dhe i aftëson ata të analizojnë përdorimet e teknologjive të shërbimit në shoqërinë e sotme.

Mundësitë për integrimin e teknologjisë brenda fushës dhe me lëndët e tjera të kurrikulës bërthamë (KB)

Integrimi i **teknologjisë** në kurrikulën e gjimnazit, kërkon **transferimin** në përgjithësi të njohurive dhe aftësive. Integrimi në kurrikulën e teknologjisë është mishërimi i lidhjeve ndërlëndore. Ai shkon deri në homogjenitetin e parimeve të mësimdhënie mësimnxënies dhe përdorimin e teknikave të njëjta në të gjitha lëndët.

Mësuesit, si përdoruesit kryesorë të programit të lëndës së teknologjisë, duhet të përpiqen ose të kenë prirjen për të mbajtur parasysh mundësitë e lidhjes së kësaj lënde me lëndët e tjera. Realizimi në praktikë i kësaj lidhjeje ndërlëndore do të ndihmonte në zhvillimin më tej të njohurive shkencore dhe do të rriste motivimin e nxënësve për këtë lëndë.

Realizimi i integritit ndërlëndor është ndër detyrat më të vështira, për arsye se çdo lëndë zë një vend të caktuar në planin mësimor të shkollës dhe ka ndërtimin e vet logjik, si dhe përcakton radhën e të mësuarit në linja, të lëndëve të ndryshme. Kjo sjell më pas që ndonjë koncept i lëndëve të tjera të fushës së shkencave të merret më përpara se në lëndën e teknologjisë. Për këtë arsye është e domosdoshme të njihet përmbajtja e lëndëve të tjera të fushës së shkencave nga mësuesit e teknologjisë.

1.4 Integrimi i teknologjisë brenda fushës, si dhe me lëndët e tjera të kurrikulës bërthamë

Teknologjia e informacionit dhe komunikimit

Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) mbështet edhe të mësuarit e teknologjisë. Nxënësit mund të përdorin programe të ndryshme, të cilat ndihmojnë në realizimin e punëve të ndryshme.



Nxënës/i,-ja duhet:

- të përdorë wordprocessor në shkrimin e shënimeve ose eksperimenteve në teknologji;
- të përdorë pajisjen e data-logging për mbledhjen, regjistrimin dhe analizën e të dhënave gjatë eksperimenteve në teknologji;
- të përdorë spreadsheet për të analizuar të dhënat dhe për të parë modelin në një grup të caktuar të dhënash;

Matematika

Nxënës/i,ja duhet:

- të dallojë figura gjeometrike plane, si trekëndëshi, drejtkëndëshi, pesëkëndëshi, gjashtëkëndëshi etj.;
- të përdorë formulat trigonometrike për marrëdhëniet e brinjëve të trekëndëshit me këndet e tij;
- të dallojë trupat gjeometrikë, si prizmi, piramida, cilindri, koni dhe elementet e tyre.

Fizika

Këtu nxënësit duhet të jenë të qartë për lidhjen e ngushtë të fizikës me teknologjinë. Njohuritë që ata mund të ndërthurin përmes teknologjisë janë të shumta.

Nxënës/i,-ja duhet:

- të përshkruajë vetitë fizike të materialeve teknologjike, si përcjellshmëria e nxehtësisë, përcjellshmëria e rrymës elektrike, gjendja fizike e materialeve etj.;
- të dallojë llojin e lëvizjes së trupit, si lëvizjet e njëtrajtshme drejtvizore dhe rrethore, lëvizjet e ndryshueshme etj., duke u nisur nga madhësitë fizike që e karakterizojnë atë;
- të bëjë dallimin ndërmjet energjisë potenciale dhe kinetike;
- të përdorë ligjin e ruajtjes dhe transformimit të energjisë;
- të shpjegojë energjinë e lëngjeve, gazeve dhe ligjet e tyre;
- të përdorë konceptet bazë të termodinamikës;
- të përshkruajë prodhimin e energjisë elektrike termike, bërthamore, bioenergjinë, diellore.

Kimia

Nxënës/i,-ja duhet:

- të shpjegojë vetitë kimike të materialeve teknologjike;
- të shpjegojë mbrojtjen e materialeve nga brejtja;
- të shpjegojë proceset kimike që ndodhin gjatë elektrolizës;
- të shpjegojë proceset kimike që ndodhin në elementin galvanik;
- të përshkruajë hidrokarburet (kimia organike).

Gjuha dhe letërsia

Gjuha është një lëndë themelore që ndihmon edhe për shprehjen sa më të saktë të koncepteve të teknologjisë, sepse nxënësit duhet të përdorin strategjitë e përshtatshme gjuhësore për të zbuluar, prezantuar dhe komunikuar të kuptuarin e tyre teknologjik.

Me lëndën e *gjuhës* integrohen njohuritë dhe aftësitë që kanë të bëjnë me hartimin e *eseve*, *gjetjen* dhe *shfrytëzimin e materialeve mediati-ke*, *shkrimin*, *leximin* dhe *komunikimin e informacioneve* për teknologjinë. Aftësitë gjykyese dhe të analizave apo qëndrimeve kritike të të menduarit reflektiv kërkojnë përdorimin e gjuhës letrare dhe profesionale. Nxënësit duhet të dinë të shprehin një ide, në forma të ndryshme gjuhësore, duke thelluar kështu të kuptuarin e tyre konceptual dhe zgjerimin e aftësive të tyre gjuhësore për komunikimin e ideve, mendimeve, qëndrimeve apo vlerësimeve të veta përballë atyre të të tjerëve.

Nxënës/i,ja duhet:

- të prezantojë duke përdorur lloje të ndryshme të medias, si: elektronike, të folur, të shkruar dhe grafike, në përputhje me përmbajtjen dhe qëllimin shkencor të prezantimit.
- të përzgjedhë informacionin shkencor në një vëllim të caktuar informacioni të tillë, p.sh.: në një artikull shkencor, në një film artistik apo shkencor.

Gjuha e huaj (anglisht)

Nxënës/i,-ja duhet:

- të analizojë dhe të interpretojë tekste dhe forma të ndryshme të komunikimit shkencor të fizikës në gjuhë të huaj, si p.sh.: me tematikë nga teknologjia;
- të shfrytëzojë fjalorin terminologjik bazë të teknologjisë në gjuhë të huaj, duke përdorur njohuritë dhe aftësitë e TIK.

1.5 Objektivat e arritjes për klasën e 12-të

LINJA 1: TEKNOLOGJIA DHE SISTEMET TEKNOLOGJIKE

Teknologjia, shoqëria, mjedisi	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojë kuptimin e termit “teknologji”; • të argumentojë rëndësinë e teknologjisë për shoqërinë njerëzore; • të bëjë klasifikimin e drejtimeve kryesore teknologjike të sotme; • të përshkruajë etapat e zhvillimit teknologjik.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> • Të analizojë se si ndikon teknologjia në transformimet e shoqërisë së sotme; • të përshkruajë ndikimin e teknologjisë në transformimet mjedisore, masat për mbrojtjen e këtij mjedisi dhe në zhvillimet e shoqërisë njerëzore; • të identifikojë mundësitë që ofron teknologjia në plotësimin e dëshirave dhe nevojave personale dhe shoqërore.
Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Të tregojë se si teknologjia bashkëvepron me shkencat dhe fushat e tjera të veprimtarisë njerëzore, sidomos me matematikën dhe shkencat natyrore; • të tregojë prirjet e zhvillimit të teknologjisë të së ardhmes.
Sistemet teknologjike	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> • Të tregojë kuptimin e termit “sistem teknologjik”; • të përshkruajë modelin e një sistemi teknologjik tipik dhe elementet kryesore të tij.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> • Të japë shembuj të sistemeve teknologjike; • të identifikojë dhe përshkruajë grupet kryesore të inputeve (burimeve) të sistemeve teknologjike; • të identifikojë dhe përshkruajë outputet (kapacitetet) e sistemeve teknologjike.

Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> •Të analizojë procese të ndryshme të sistemeve teknologjike; •të shpjegojë rolin dhe veprimin e mekanizmave të feedbackack (lidhjes së kundërt) në sistemet teknologjike.
Sistemet teknologjike dhe zgjidhja e problemit teknologjik	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> •Të shpjegojë kuptimin e koncepteve “problem”, “problem teknologjik” dhe “zgjidhje e një problemi teknologjik”; •të tregojë se çfarë përmban projekti (plani) për zgjidhjen e një problemi teknologjik.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> •Të rendisë hapat që ndiqen për zgjidhjen e një problemi teknologjik dhe të argumentojë domosdoshmërinë e secilit prej tyre; •të përshkruajë veçoritë e hapave që ndiqen për zgjidhjen e një problemi teknologjik.
Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> •Të japë një shembull të një problemi teknologjik të thjeshtë dhe të ndërtojë skemën e procedurës së zgjidhjes së tij; •të analizojë opsionet (zgjedhjen e parapëlqyer) për zgjidhjen e një problemi teknologjik dhe të përzgjedhë opsionin më të mirë.

LINJA 2: KOMUNIKIMI GRAFIK

Komunikimi grafik dhe lidhja e tij me teknologjinë	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojë ç'është komunikimi grafik.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojë lidhjen e komunikimit grafik me disa nga degët kryesore të teknologjisë, si: teknologjia e mekanikës, teknologjia e elektricitetit, teknologjia e konfeksioneve, teknologjia e ndërtimit etj.
Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Të analizojë lidhjen e komunikimit grafik me disa nga degët kryesore të teknologjisë, si: teknologjia e mekanikës, teknologjia e elektricitetit, teknologjia e konfeksioneve, teknologjia e ndërtimit etj.
Skicimi dhe njohuri kryesore për komunikimin grafik	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> • Të njohë dhe të përdorë materialet dhe veglat kryesore që përdoren në kryerjen e skicave dhe vizatimeve: letrat për skica, letrat për vizatime, lapsat që përdoren për skica dhe vizatime, gomat fshirëse, vizoret matëse, trekëndëshat e vizatimit, kompaset etj.; • të njohë dhe përdorë llojet kryesore të vijave që përdoren në skica dhe vizatime; • të skicojë vija të pozicioneve të ndryshme, kënde 90°, 30°, 45°, 60°, harqe, figurat gjeometrike kryesore si: rreth, elips, gjashtëkëndësh etj.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> • Të përdorë metodën grafike të zmadhimit dhe zvogëlimit të figurave; • të përdorë format standarde të shkronjave dhe shifrave në skica dhe vizatime; • të përdorë rregullat kryesore të vendosjes së përmasave në leximin dhe kryerjen e skicave dhe vizatimeve.

Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Të bëjë ndërtime gjeometrike duke përdorur veglat e vizatimit, si: -ndarje segmentesh dhe rrrathësh në pjesë të barabarta, -ndërtime shumëkëndëshash, - kalime të rrjedhshme midis dy drejtëzash, drejtëzës dhe rrethit dhe midis dy rrrathëve; • të realizojë skica të vështirësisë mesatare duke përdorur njohuritë për vijat e vizatimit për ndërtimet gjeometrike, për shkrimin teknik dhe vendosjen e përmasave.
Paraqitja e objekteve me anë të projeksioneve kënddrejta	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> • Të ndërtojë projeksione kënddrejta të objekteve të thjeshta; • të përdorë shkallët e vizatimit; • të bëjë skica të objekteve të thjeshta.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> • Të lexojë skica dhe vizatime të objekteve të thjeshta dhe të vështirësisë mesatare.
Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Të bëjë skica dhe vizatime të objekteve të vështirësisë mesatare.
Paraqitjet me prerje	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> • Të njohë kuptimin gjeometrik të paraqitjes me prerje; • të bëjë shënimin e prerjeve sipas standardit të vizatimit; • të bëjë vijëzimet e sipërfaqeve të prera; • të përdorë prerjet e thjeshta në paraqitjen e objekteve; • të lexojë skica dhe vizatime të objekteve të thjeshta të paraqitur me prerje.

Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> • Të lexojë skica dhe vizatime me prerje të objekteve të vështirësisë mesatare; • të bëjë skica dhe vizatime të objekteve të thjeshta duke përdorur prerjet.
Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Të bëjë skica dhe vizatime të objekteve të vështirësisë mesatare duke përdorur prerjet e thejshta; • të përdorë bashkimet e pamjeve me prerjet në skicat dhe vizatime.
Paraqitjet aksonometrike dhe hapjet e sipërfaqeve	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> •Të njohë kuptimin gjeometrik të paraqitjeve aksonometrike; •të ndërtojë me veglat e vizatimit dhe me dorë të lirë boshtet aksonometrikë për dimetrinë këndngushtë dhe izometrinë kënddrejtë; •të ndërtojë paraqitjet aksonometrike të figurave të rrafshëta (katrorit, drejtkëndëshit, trekëndëshit, gjashtëkëndëshit, rrethit); •të ndërtojë paraqitjet aksonometrike të trupave gjeometrikë kryesorë dhe objekteve të thjeshta të dhëna në projeksionet kënddrejta ose në natyrë.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> •Të bëjë hapjen e sipërfaqeve të prizmave, piramidave, cilindrave dhe konit të dhënë në projeksionet kënddrejta; •të ndërtojë projkesionet aksonometrike të objekteve të vështirësisë mesatare.
Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> •Të bëjë hapjen e sipërfaqeve të prizmit dhe cilindrit të prerë pjerrtas; •të bëjë hapjen e sipërfaqeve të objekteve të thjeshta të përgatitura prej materialesh në formë fletësh.
Vizatimet e ndërtimit	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve

Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> • Të lexojë vizatimet e planeve të përgjithshme (genplanet) dhe të përcaktojë në to objektet e ndryshme; • të lexojë planet (planimetritë) e objekteve të banimit dhe të përcaktojë elementet e objektit; • të lexojë planet e mobilimit të objekteve të banimit.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> • Të përcaktojë e elementet konstruktivë në vizatimet konstruktive të objekteve të ndërtimit.
Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Të bëjë planimetrinë e një apartamenti banimi.
Vizatimet skematike	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojë simbolet e elementeve kryesore të vizatimeve skematike (skemave elektrike, kinematike dhe hidrosanitare); • të lexojë skema të thjeshta elektrike, kinematike dhe hidrosanitare; • të zbatojë skema të thjeshta elektrike, kinematike dhe hidrosanitare.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> • Të lexojë skema të thjeshta dhe të vështirësisë mesatare elektrike, kinematike dhe hidrosanitare.
Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Të bëjë skema të thjeshta elektrike, kinematike dhe hidrosanitare.

LINJA 3: MATERIALET TEKNOLOGJIKE

Teknologjia dhe materialet teknologjike	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> •Të shpjegojë konceptin e “materialeve teknologjike”; •të përshkruajë etapat kryesore të zhvillimit të materialeve teknologjike.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> •Të klasifikojë materialet teknologjike sipas grupeve kryesore; •të identifikojë materialet teknologjike kryesore.
Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> •Të argumentojë rëndësinë që kanë materialet teknologjike për teknologjinë e sotme dhe zhvillimin ekonomik dhe shoqëror; •të analizojë se si ndikojnë vetitë e materialeve teknologjike në teknologjinë e sotme.
Vetitë dhe përdorimet e materialeve teknologjike	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	•Të përshkruajë vetitë teknologjike të materialeve teknologjike sipas grupeve të ndryshme.
Niveli i mesëm	•Të tregojë dhe të japë shembuj të përdorimit të materialeve teknologjike sipas grupeve të ndryshme.
Niveli i lartë	•Të tregojë prirjet kryesore të zhvillimit dhe përdorimit të materialeve teknologjike të së ardhmes.

LINJA 4: STRUKTURAT DHE MEKANIZMAT

Strukturat dhe mekanizmat	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> • Të tregojë kuptimin e strukturave dhe mekanizmave teknologjike; • të përshkruajë etapat e zhvillimit të strukturave dhe mekanizmave teknologjike.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> • Të klasifikojë strukturat dhe mekanizmat teknologjike kryesore; • të japë shembuj të përdorimit të strukturave dhe mekanizmave teknologjike kryesore.
Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojë strukturat dhe mekanizmat teknologjike kryesore; • të argumentojë rëndësinë e përdorimit të strukturave dhe mekanizmave në teknologjinë e sotme.
Ndërtimi dhe funksionimi i strukturave dhe mekanizmave teknologjike kryesore	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojë dhe të përshkruajë pjesët e veçanta (detalet) të strukturave dhe mekanizmave teknologjike; • të identifikojë dhe të përshkruajë bashkimet kryesore që përdoren në strukturat dhe mekanizmat teknologjike.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> • Të identifikojë dhe të përshkruajë ndërtimin e mekanizmave kryesore që përdoren në sistemet dhe strukturat teknologjike; • të identifikojë dhe të përshkruajë ndërtimin e transmiseve kryesore që përdoren në sistemet dhe strukturat teknologjike; • të japë shembuj të detaleve, bashkimeve, mekanizmave dhe transmiseve kryesore që përdoren në strukturat teknologjike.

Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> •Të përshkruajë funksionimin e mekanizmave kryesore që përdoren në sistemet dhe strukturat teknologjike; •të përshkruajë funksionimin e transmiseve kryesore që përdoren në sistemet dhe strukturat teknologjike.
-----------------------	--

LINJA 5: TEKNOLOGJIA E PRODHIMIT

Sistemet teknologjike të prodhimit	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> •Të tregojë kuptimin e “teknologjisë së prodhimit”.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> •Të klasifikojë llojet kryesore të teknologjive të prodhimit.
Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> •Të përshkruajë veçoritë e llojeve kryesore të teknologjive të prodhimit; •të argumentojë rëndësinë e teknologjisë së prodhimit për shoqërinë e sotme.
Teknologjia e prodhimit të energjisë	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> •Të tregojë kuptimin e “teknologjisë së prodhimit të energjisë elektrike”.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> •Të përshkruajë mënyrat dhe teknologjitë kryesore të prodhimit të energjive të llojeve të ndryshme; •të japë shembuj të përdorimit të teknologjisë së prodhimit të energjisë.
Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> •Të argumentojë rëndësinë e teknologjisë së prodhimit të energjisë për ekonominë dhe shoqërinë; •të tregojë prirjet e teknologjisë së prodhimit të energjisë për shoqërinë e së ardhmes.

Teknologjia e prodhimit industrial	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> • Të tregojë kuptimin e “teknologjisë së prodhimit industrial”.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> • Të klasifikojë llojet kryesore të teknologjisë së prodhimit industrial; • të përshkruajë veçoritë kryesore të teknologjisë së prodhimit industrial.
Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Të argumentojë rëndësinë dhe përdorimet e teknologjisë së prodhimit industrial për ekonominë dhe shoqërinë e sotme; • të tregojë prirjet e teknologjisë së prodhimit industrial për ekonominë dhe shoqërinë e së ardhmes.
Teknologjia e prodhimit artizanal	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> • Të tregojë kuptimin e “teknologjisë së prodhimit artizanal”.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> • Të klasifikojë llojet kryesore të teknologjive të prodhimit artizanal; • të përshkruajë veçoritë kryesore të teknologjisë së prodhimit artizanal.
Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> • Të argumentojë rëndësinë dhe përdorimet e teknologjisë së prodhimit artizanal për ekonominë dhe shoqërinë e sotme; • të tregojë prirjet e teknologjisë së prodhimit artizanal për ekonominë dhe shoqërinë e së ardhmes.
Teknologjia e prodhimit bujqësor	Objektiva specifike
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> • Të tregojë kuptimin e “teknologjisë së prodhimit bujqësor”.

Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> •Të klasifikojë llojet kryesore të teknologjisë së prodhimit bujqësor; •të përshkruajë veçoritë kryesore të teknologjisë së prodhimit bujqësor.
Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> •Të argumentojë rëndësinë dhe përdorimet e teknologjisë së prodhimit bujqësor për ekonominë dhe shoqërinë e sotme; •të tregojë prirjet e teknologjisë së prodhimit bujqësor për ekonominë dhe shoqërinë e së ardhmes.

LINJA 6: TEKNOLOGJIA E SHËRBIMEVE

Sistemet teknologjike të shërbimeve	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> •Të tregojë kuptimin e “teknologjisë së shërbimeve”.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> •Të klasifikojë llojet kryesore të teknologjive të shërbimeve.
Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> •Të përshkruajë veçoritë e llojeve kryesore të teknologjive të shërbimeve; •të argumentojë rëndësinë e teknologjisë së shërbimeve për shoqërinë e sotme.
Teknologjia e shërbimeve të komunikimit	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> •Të tregojë kuptimin e “teknologjisë së shërbimeve të komunikimit”.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> •Të klasifikojë llojet kryesore të teknologjisë së shërbimeve të komunikimit; •të përshkruajë veçoritë kryesore të teknologjisë së shërbimeve të komunikimit.

Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> •Të argumentojë rëndësinë dhe përdorimet e teknologjisë së shërbimeve të komunikimit për ekonominë dhe shoqërinë e sotme; •të tregojë prirjet teknologjisë së shërbimeve të komunikimit për ekonominë dhe shoqërinë e së ardhmes.
Teknologjia e shërbimeve të transportit (shpërndarjes)	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> •Të tregojë kuptimin e “teknologjisë së shërbimeve të transportit”.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> •Të klasifikojë llojet kryesore të teknologjisë së shërbimeve të transportit; •të përshkruajë veçoritë kryesore të teknologjisë së shërbimeve të transportit.
Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> •Të argumentojë rëndësinë dhe përdorimet e teknologjisë së shërbimeve të transportit për ekonominë dhe shoqërinë e sotme; •të tregojë prirjet e teknologjisë së shërbimeve të transportit për ekonominë dhe shoqërinë e së ardhmes.
Teknologjia e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit	Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve
Niveli bazë	<ul style="list-style-type: none"> •Të tregojë kuptimin e “teknologjisë së shërbimeve të mirëmbajtjes”.
Niveli i mesëm	<ul style="list-style-type: none"> •Të klasifikojë llojet kryesore të teknologjisë së shërbimeve të mirëmbajtjes; •të përshkruajë veçoritë kryesore të teknologjisë së shërbimeve të komunikimit.
Niveli i lartë	<ul style="list-style-type: none"> •Të argumentojë rëndësinë dhe përdorimet e teknologjisë së shërbimeve të mirëmbajtjes për ekonominë dhe shoqërinë e sotme; •të tregojë prirjet teknologjisë së shërbimeve të mirëmbajtjes për ekonominë dhe shoqërinë e së ardhmes.

1.6 Zbërthimi i objektivave të programit në objektiva specifike sipas niveleve të arritjes nga nxënësit

a) Si të hartojmë objektivat specifike në tri nivele^{2*}

Përsa u përket disa termave që lidhen me objektivat, pranohet që të shkruhet dhe të flitet për “veprimtari” që shfaq nxënësi për të demonstruar arritjet e tij, si p.sh.:

“përshkruan”, “shpjegon”, “liston”, “mbledh”, “ndërton”, “harrton”, “krijon”përkufizon”, “përsërit”, “shkruan”, “diskuton”, “përfshihet”, “respekton”etj., ndonëse në materiale të ndryshme shkruhet edhe “veprimi”ose “sjellja”.

Objektivat e *sjelljes*, ose të *veprimit*, me *objektivat e arritjeve (performancës)*, janë e njëjta gjë. Por kjo gjë merr kuptim më të plotë kur thuhet që: *nxënësit janë përfshirë në veprimtari për arritjen e objektivave*, sesa të thuhesh se nxënësit janë përfshirë në veprime, ose sjellje për arritjen e objektivave.



Po kështu pranohet përdorimi i termit “**kushtet**” e shfaqjes së veprimtarisë që është i aftë që të kryejë nxënësi (“me mjete”, “përmendësh”, “nga kujtesa”, “në eksperiment” etj.), si dhe “**kriteret**”, që përdoren për të vlerësuar produktin e prodhuar nga nxënësi. Kriteri mund të mos shkruhet kur nënkuptohet, por nuk mund të shmanget kur është fjala për modalitetet e vlerësimit. Kështu, për shembull, vlerësimi që përdoret kur mësuesi do të nxjerrë notën përfundimtare të nxënësit është i bazuar në “kriteret”, d.m.th., në nivelin e arritjeve që demonstroi nxënësi, në raport me objektivat e programit, ose në raport me standardet.

Termi “*objektiv mësimor*” (shkurt “objekt”), shërben për të treguar parimet, teoritë, ligjet, konceptet, rregullat, shkaqet, pasojat, krahasimet, lidhjet, formulat, simbolet, emrat, datat, modelet etj., që shqyrtohen në programin e lëndës, mbi të cilat bien veprimtari e nxënësve.

Por, nga ana tjetër, objekti përbën edhe **produktin** e nxënësit. Pra,

*Ky material është marrë nga materiali i përgatitur nga grupi i specialistëve pranë QKTA në vitin 2007.

në fund të fundit, dy pjesët më themelore të një objektivi janë:

Objekti + Veprimtaria = Objektiv ose **Veprimtaria + Produkti = Objektiv**

- Të analizojë lidhjen e komunikimit grafik me disa nga degët kryesore të teknologjisë, si: teknologjia e mekanikës, teknologjia e elektricitetit, teknologjia e konfeksioneve, teknologjia e ndërtimit etj.

► Që nxënësi të bëhet i aftë për të analizuar lidhjen e komunikimit grafik me disa nga degët kryesore të teknologjisë, ai duhet të jetë në gjendje:

- të përshkruajë disa nga degët kryesore të teknologjisë;
- të analizojë karakteristikat e degëve kryesore të teknologjisë.

a) Nivelet e arritjeve

- *Niveli bazë, mesatar dhe i lartë*
- *Objektivi minimal*
- *Nivelet relative*

Përsa i përket hierarkisë së arritjeve të nxënësve, ne do të ruajmë terminologjinë e futur te standardet: niveli **bazë** (më i ulëti) i arritjeve, niveli **mesatar** dhe niveli i **lartë**. Ndarja në nivele e objektivave të arritjeve, është më e vështirë se edhe vetë formulimi i objektivave.

Vështirësia e parë është ajo se vetë objektivat e programit janë të niveleve të ndryshme. Po t'i referohemi klasifikimit të Blumit për nivelet e njohjes, atëherë, për objektivat e ndryshëm të programeve do të gjenim se;

- Nëse nxënësi *duhet të japë përkufizimin* e një ligji, ky objektivi është i nivelit bazë (në nivelin 1).
- Nëse nxënësi *shpjegon me fjalët e tij*, kjo është e nivelit bazë (në nivelin 2).
- Nëse nxënësi *zbaton një formulë* në një ushtrim të ri, kjo është e nivelit mesatar.
- Nëse nxënësi *zgjidh një problem kompleks*, kjo përfshin ndoshta të gjitha nivelet, deri te më i larti.

c) Formulimi i objektivave specifike

Për të formuluar qartë një objektiv specifik, vlejné kriteret e mëposhtme:

1. Shkruaj **veprimtarinë** e vëzhgueshme (sjelljen), që do të thotë se duhet të shkruhet ajo, që nxënësi duhet të jetë i aftë të realizojë për të provuar se e ka arritur objektivin. Ky është një rregull i detyrueshëm.

2. Shkruaj **kushtet**, në të cilat duhet të manifestohet veprimtaria (sjellja). Saktësimi i këtyre kushteve lejon që objektivi të konturohet më mirë, që të sqarohen kufijtë e tij.

3. ***Kushtet mund të jenë:***

- saktësime (“duke pasur të dhënë...”);
- autorizime (“me ndihmën e...”);
- ndalime (“pa asnjë referencë...” etj.);
- nga memoria (përmendësh);
- duke pasur ose jo një listë, tabelë, i jepet një vizatim, figurë, ose mjet (kompas, vizore, gërshërë), aparat, pajisje, substancë, hartë;
- i jepet një rregull, formulë, ligj etj.;
- veprimi do të kryhet në klasë, në palestër, në laborator, jashtë etj.

4. Saktëso **kriterin e suksesit**, arritjes (performancës). Duke saktësuar arritjen minimale, mund të gjykojmë për arritjen e objektivit. Shembuj kriteresh janë: koha e kryerjes, përqindja e përgjigjeve të mira etj.

Kur formulon një **objektiv specifik**, pasi përcakton se cilit nivel shkollimi i përket ai (kjo në rastin tonë është e zgjidhur nga programi), duhet t’u përgjigjesh edhe pyetjeve të mëposhtme:

1. Cila është veprimtaria e vëzhgueshme që do të tregojë se objektivi është arritur ?
2. Cili do të jetë objekti (produkti) i kësaj veprimtarie (arritjeje) ?
3. Në cilat kushte do të ketë vend veprimtaria ?

4. Cilat kritere do të shërbejnë për të përcaktuar nëse produkti është i kënaqshëm ?

Duke mbledhur termat e përdorura themi:

1. *Objektiv specifik* - kur duam të tregojmë se ky objektivi është degëzim i një objektivi të përgjithshëm.
2. *Objektiv veprues* - kur duam të theksojmë se objektivat specifike janë objektiva që tregojnë veprimtaritë e nxënësve.
3. *Klasifikimet (taksonomitë) e sjelljeve* - kur duam të planifikojmë se çfarë veprimtarie duhet të bëjë nxënësi, për të përvetësuar një aftësi, një arritje të synuar.
4. *Objektivat e aftësive* - kur bëhet fjalë për aftësitë që synohen, çka është më e përgjithshme se veprimi, sepse për të arritur një aftësi mësuesit i duhet të përcaktojë veprimet përkatëse.
5. *Objektivat e arritjeve* - kur duam të tregojmë në përgjithësi një arritje, për të cilën duhet të gjejmë aftësitë përkatëse dhe që këtej, veprimet e sjelljet. Arritjet mund të formulohen edhe si objektiva të ndërmjetëm, ose si objektiva specifike.

Teknologjia e shërbimeve të transportit (shpërndarjes)

Objektivat e ndarë sipas 3 niveleve të programit dhe të specifikuara për çdo nivel	
<p>Niveli bazë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të tregojë kuptimin e “teknologjisë së shërbimeve të mirëmbajtjes”. 	<p>Niveli specifik për çdo objektivi</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të përkufizojë shërbimet e transportit në shoqërinë e sotme. 2. Të rendisë momentet kyçe historike të zhvillimit të teknologjisë së shërbimeve të transportit. 3. Të përshkruajë ecurinë e zhvillimit të teknologjisë së shërbimeve të transportit në secilën nga etapat historike.

<p>Niveli i mesëm</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të klasifikojë llojet kryesore të teknologjisë së shërbimeve të transportit. 	<p>Niveli specifik për çdo objektiv</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të rendisë tri llojet kryesore të shërbimeve të transportit të mallrave dhe njerëzve. 2. Të tregojë cilat janë dhe pse përdoren mjete kryesor të transportit tokësor, ujor dhe ajror. 3. Të tregojë llojet dhe funksionet e sistemeve mbështetëse të mjeteve të transportit tokësor, ujor dhe ajror.
<ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajë veçoritë kryesore të teknologjisë së shërbimeve të transportit. 	<p>Niveli specifik për çdo objektiv</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të tregojë cilat janë veçoritë konstruktive dhe funksionet e sistemeve kryesore të mjeteve të transportit tokësor. 2. Të tregojë cilat janë veçoritë konstruktive dhe funksionet e sistemeve kryesore të mjeteve të transportit ujor. 3. Të tregojë cilat janë veçoritë konstruktive dhe funksionet e sistemeve kryesore të mjeteve të transportit ajror. 4. Të tregojë cilat janë veçoritë konstruktive dhe funksionet e sistemeve kryesore të mjeteve të transportit.
<p>Niveli i lartë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të argumentojë rëndësinë dhe përdorimet e teknologjisë së shërbimeve të transportit për ekonominë dhe shoqërinë e sotme. 	<p>Niveli specifik për çdo objektiv</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të rendisë epërsitë që i sjell ekonomisë dhe shoqërisë përdorimi dhe zhvillimi i teknologjisë së shërbimeve të transportit. 2. Të analizojë parametrat kryesore të shërbimeve të transportit të tilla, si kostoja, shpejtësia, rehatia, siguria dhe vëllimi i transportit.

<ul style="list-style-type: none">• Të tregojë prirjet teknologjisë së shërbimeve të transportit për ekonominë dhe shoqërinë e së ardhmes.	<p>Niveli specifik për çdo objektiv</p> <ol style="list-style-type: none">1. Të argumetojë përfitimet ekonomike dhe shoqërore që vijnë nga investimi në drejtim të kërkimit dhe zhvillimit të teknologjive të reja për shërbimet e transportit.2. Të rendisë drejtimet kryesore, në të cilat po punohet për zhvillimin e mëtejshëm të teknologjisë së shërbimeve të transportit.3. Të tregojë veçoritë e modeleve të fundit dhe modeleve të së ardhmes në teknologjinë e shërbimeve të transportit.
--	---

PJESA E DYTË

2. METODOLOGJIA DHE MJETET MËSIMORE PËR ZHVILIMIN E LËNDËS

Lënda ka si qëllim pajisjen e nxënësve me arsim teknologjik, i cili konsiderohet si pjesë e kulturës së përgjithshme të njeriut. Kjo është mbajtur parasysh gjatë hartimit të programit dhe duhet të mbahet mirë parasysh nga hartuesit e teksteve dhe nga mësuesit që do ta japin lëndën, duke synuar shmangien e karakterit të theksuar profesional të trajtimit të përmbajtjes së materialit mësimor.

Për t'u realizuar objektivat e lëndës “Teknologjia”, kërkohet angazhim mendor, emocional dhe fizik i nxënësve. Kjo arrihet nëpërmjet ndërthurjes së tri fushave të të mësuarit: njohëse, afektive dhe psikomotore.

Fusha **njohëse** ka të bëjë me realizimin e atyre objektivave, që lidhen me fitimin e kuptimit dhe njohurive dhe me zhvillimin e shkathtësive e shprehive intelektuale të nxënësve. Për këtë është e nevojshme që gjatë parashtrimit të njohurive nga ana e mësuesit të tërhiqet edhe mendimi i nxënësve, duke shfrytëzuar njohuritë që ata kanë fituar nga lëndët e tjera, nga leximet e pavarura e nga media, si dhe përvojën jetësore vetjake. Por, zhvillimi i të menduarit mund të arrihet në shkallë të lartë kryesisht nëpërmjet aktivizimit të nxënësve në veprimtari praktike dhe eksperimentale, gjatë të cilave përdoren materiale, vegla, aparate e makina të ndryshme.

Fusha **afektive** ka të bëjë me ato objektiva që lidhen me interesat, dëshirat, qëndrimet, vlerat dhe emocionet e nxënësve. Edhe në këtë fushë ndikon fuqishëm angazhimi i nxënësve në veprimtari praktike, gjatë të cilave ata gjejnë mundësi të shfaqin origjinalitetin e tyre në drejtim të parashtrimit të mendimeve, përballimit të vështirësive, shfrytëzimit të vlerave vetjake, të provuarit të emocioneve të ndryshme gjatë realizimit të veprimtarisë etj.

Fusha **psikomotore** ka të bëjë me realizimin e atyre objektivave që lidhen me formimin dhe zhvillimin e shkathtësive dhe shprehive lëvizore të nxënësve, gjë që arrihet nëpërmjet angazhimit të tyre në veprimtari praktike. Megjithatë, duhet thënë se zhvillimi psikomotor nuk është synim parësor në të mësuarit e teknologjisë, prandaj veprimtaria praktike e nxënësve shihet më tepër si një rrugë e rëndësishme për zhvillimin njohës dhe afektiv se sa psikomotor të tyre.

Të mësuarit e teknologjisë sipas këtij konceptimi përputhet me natyrën e vetë teknologjisë si fushë dijesh e veprimtarie. Ai nuk mund të bëhet thjesht në një mjedis akademik, por kërkon mundësisht ngritjen e kabineteve e laboratorëve të posaçme, të cilat gradualisht të plotësohen me pajisje për të siguruar aktivizimin e mësuesve dhe sidomos të nxënësve gjatë gjithë trajtimit të lëndës. Njëkohësisht, mund dhe duhet të shfrytëzohen edhe kabinetet e laboratorët që ka shkolla për lëndët e tjera, veçanërisht ato të shkencave natyrore. Kjo do të ndihmonte për shfrytëzimin në teknologji të koncepteve dhe të shkathësive të fituara në lëndë të tjera, shikimin e këtyre lëndëve nga nxënësit si pjesë e një të tërë të madhe dhe jo si njësi të veçanta.

Mësuesit e teknologjisë duhet të përdorin një larmi të madhe strategjish mësimore, në mënyrë që të arrihet aktivizimi maksimal i nxënësve jovetëm brenda orës së mësimit, por edhe gjatë përgatitjes së tyre jashtë mjediseve të shkollës. Qëllimit të fundit i shërben dhënia e detyrave të ndryshme, si leximi i literaturës (dhe jo vetëm i tekstit); shfrytëzimi i burimeve të ndryshme të medias, sidomos i asaj të shkruar; intervistimi i personave me profesione të ndryshme; analiza e parimeve dhe e koncepteve të shkencës, matematikës dhe teknologjisë të zbatuara në një objekt teknologjik; shqyrtimi i mundësive për përmirësime teknologjike në shtëpi (p.sh., për ndriçimin) e mjedise të tjera; krijimi i posterave, ndërtimi i modeleve, paraqitja me shkrim e përvojave të tyre etj. Materialet e përfutuara nga këto detyra, duke u përdorur në klasë, i gjallërojnë shumë orët e mësimit.

Për të mësuarit e teknologjisë duhet të shfrytëzohet edhe mjedisi gjeografik ku ndodhet shkolla. Për këtë qëllim mund të organizohen vizita nëpër muzeume, në mjedise të ndryshme pune e prodhimi, mjedise kulturore-artistike etj.

Orët mësimore

Programi i Teknologjisë për klasën e 12^{te} është strukturuar në linja që kanë një renditje të caktuar, e cila duhet respektuar gjatë vitit shkollor.

Sasia e orëve mësimore për secilën nënlinjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, por janë të lirë të ndryshojnë me **10% (shtesë ose pakësim)** numrin e orëve të rekomanduara për secilën linjë.

Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë kur e vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të linjës, por mund të ecë më shpejt, kur nxënësit e tij demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës “Teknologjia” afërsisht 70% e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe 30% e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë dhe në fund të vitit shkollor).

Meqenëse veprimtaritë praktike dhe eksperimentale janë pjesë e programit dhe kanë rëndësi të veçantë për realizimin me sukses të tij, rreth 20% e orëve të përgjithshme të planifikuara për klasë, u lihen këtyre veprimtarive.

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Përsëritjen brenda linjave të njohurivebazë të tij (konceptet themelore).
- Testimin e njohurive bazë.
- Integrimin e njohurive të reja të një linje me njohuritë e linjave para-ardhëse.
- Integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme).
- Projektin kurrikular lëndor.
- Përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja, lënda duhet parë si e tërë).
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të marrin shtysë nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve. Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t’i kushtohet kohë e posaçme kultivimit:

- Të aftësive të përgjithshme, si: e komunikimit, e manaxhimit të informacionit, e zgjidhjeve problemore, e të menduarit kritik dhe krijues;
- të aftësive të posaçme që kanë të bëjnë me lidhjen e njohurive me jetën e përditshme etj;

- të formimit të qëndrimeve etiko-sociale dhe të atyre që lidhen me aftësinë për të punuar në ekip.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike, projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet e metodat themelore të kësaj lënde.

PJESA E TRETË

3. Vlerësimi i nxënësit

Një nga çështjet që duhet mbajtur parasysh nga mësuesit e Teknologjisë është edhe **vlerësimi i nxënësve**. Ai lipset t'i përgjigjet angazhimit mendor, emocional dhe fizik të nxënësve. Kjo arrihet nëpërmjet ndërthurjes së tri fushave të të mësuarit: njohëse, afektive dhe psikomotore.

Në përputhje me to, kërkohet që vlerësimi i nxënësve të mbështetet jo thjesht në riprodhimin që ata i bëjnë materialit të tekstit (pavarësisht se ky është burimi kryesor i shkruar për njohjen me teknologjinë), por në shkallën e aktivizimit të nxënësit në të gjitha aspektet e veprimtarisë mësimore, origjinalitetin e shfaqur prej tij në përgjigjet ndaj pyetjeve, në punën e pavarur brenda e jashtë shkollës.

Vlerësimi i nxënës/it,-es përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënës/it,-es nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ata objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si: qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Mësues/i,-ja ndihmon nxënësit që së bashku të zhvillojnë një larmi

mënyrash vlerësimi, si: me shkrim, me gojë, me projekte, me përgatitje të maketeve, të modelimeve dhe simulimeve kompjuterike të eksperimenteve etj.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënës/i,-ja vlerësohet me notë ndërsa demonstroi arritjet e tij/saj.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësues/i,-ja parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësues/i,-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet lirshëm të bashkëbisedojnë si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe realizimit me sukses të detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësues/i,-ja vlerëson nxënës/in,-en me notë për parashtrimet me shkrim, në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij/saj, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësues/i,-ja planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një a disa linja, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet disaminutëshe për një objektivi të veçantë të të nxënësit, tek ato njëorëshe; teste me alternativa ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.

Portofoli i nxënës/it,-es, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi dhe informacioni të prindërit të progresit të nxënësit, është një koleksion i punimeve të tij/saj përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare etj. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësues/i,-ja rekomandon.

Çrregullime të diagnostikuara, si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh., të nxënësve të ardhur rishtas nga emigracioni, merren

parasysh nga mësuesi duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, duke përjashtuar atë me shkrim apo me gojë.

Zbatuesit e programit duhet të kenë parasysh se vlerësimi i nxënësve vetëm me teste është i pjesshëm dhe nuk jep informacion të plotë mbi atë se çfarë di dhe çfarë është në gjendje të bëjë nxënësi. Testet tradicionale, si ato me zgjedhje të shumëfishtë apo me përgjigje të shkurtër në fund të një linje, nuk vlerësojnë dot se sa di nxënës/i,-ja të planifikojë e realizojë një eksperiment, të bëjë vrojtime dhe matje të sakta, të analizojë të dhënat dhe të nxjerrë përfundime.

PJESA E KATËRT

Orë mësimi model të zbërthyer në objektiva

Organizimi i strategjisë së orës së mësimit

(Lënda Teknologji)

Tema :

FAZA I : PARAQITJA

1. Kalimi (tregohet se për çfarë do të mësojë nxënësi sot, ose në kapitullin që fillon).
2. Përgjigjja për pyetjet që u kanë dalë nxënësve për detyrat e shtëpisë.
3. Përgjigjja për fletën e ushtrimeve që kishin për të zgjidhur.
4. Rifreskimi i çështjeve kryesore të mësimit të kaluar.
5. Minitest.
6. Diskutimi rreth mësimit të kaluar.
7. Motivimi (pyetje, situatë, eksperiment).
8. Detyra fillestare.
9. Shqyrtohet një dokument.
10. Shqyrtohet një objekt apo situatë.
11. Përdorimi për herë të parë i termit.
12. Ushtrimi ndërmjetës.

13. Vizitë studimore jashtë klasës.
14. Një punë kërkimore paraprake.
15. Dhënia e objektivave.
16. Rifreskohen dijet paraprake rreth temës së re.
17. Nxënësi lidh njohuritë e reja me ato të mëparshme.

Shënim: Shumë nga procedurat e mësipërme janë alternativa me “ose”. Kështu për shembull, mund të jetë vetëm njëra nga 3, ose 4; njëra nga 5 ose 6; njëra ose vetëm disa nga 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14. Por numrat 1,7,15 dhe 16 janë të parivalizueshëm. Kjo vlen edhe për fazat e tjera.

Disa nga hapat e fazës së dytë dhe të tretë përbëjnë atë që quhet shpjegimi i lëndës së re.

FAZA I : ZHVILLIMI

1. Metoda induktive për objektin e ri të të mësuarit. Kalimi gradual nëpërmjet asaj që dinë nxënësit.
2. Informacioni shtesë.
3. Paraqitja e përkufizimit, rregullës, formulës, ligjit etj.
4. **Veprimtaritë zhvilluese (hapa të renditur për studimin e objektit).**
5. Dhënia e detyrës për grupet.
6. Puna me grupe, lojë me role, simulim.
7. Prezantimi i grupeve dhe diskutimi plenar.
8. Ilustrimi.
9. Demonstrimi apo paraqitja e modeleve.
10. Kthimi në situatën fillestare.
11. Organizimi i objekteve të të mësuarit.
12. Ngulitja e objekteve të të mësuarit.

FAZA I : ZBATIMI

1. Ushtrimet zbatuese.
2. Pyetjet për të kuptuarit.
3. Ushtrimet për përforcim (trajnimi).
4. Korrigjimi i gabimeve.
5. Ushtrimet plotësuese.
6. Vlerësimi për dijet e përvetësuara.

FAZA IV : INTEGRIMI

1. Lidhja me fushat e tjera të njohurive.
2. Transferta vertikale dhe horizontale.
3. Zhvillimi i situatave integruese.
4. Vlerësimi i integritit të njohurive të përfuara.

Shpjegime për formatin e planit të orës së mësimit

Klasa _____

Lënda

Tema _____

Qëllimet: Formulimi i qëllimeve bëhet duke mbajtur parasysh qëllimet që jepen në pjesën e përgjithshme të programeve.

Objektivat: Formulimi i objektivave bëhet duke mbajtur parasysh objektivat e kapitujve të programit, si dhe objektivat vjetorë që shënohen në disa programe.

Memorizimi

Te kutia e memorizimit shkruhet se çfarë objektesh do të mbajë për-mendësh nxënësi (kategori, përku-fizime, procedura, ligje, rregulla, formula, ngjarje, data, emra, ske-ma, teo-rema, tipe ushtrimesh etj.

Shprehitë

Te kutia e shprehive shënohen shprehitë, për të cilat do të ushtrohen nxënësit, të zgjidhë një ekuacion, të përshkruajë një dukuri ose ngjarje, të zbatojë një pro-cedurë, të demonstrojë shprehitë të punës në grup, në debat, në diskutim, etj. Shprehitë mund të jenë koniunktore, qëndrime, vlera, shprehitë psiko-motore.

Strategjia:

Te kjo pjesë paraqiten hapat që do të hidhen në orën e mësimit, si p.sh.:

- Prezantohet temën e mësimit dhe objektivat.
- Iu përgjigjen pyetjeve të nxënësve për detyrat e shtëpisë, për mësimin e kaluar etj.
- Bëj pyetje për të kuptuarit e mësimit të kaluar.
- Prezantohet çështjen _____
- _____
- _____

Instrukcionet për përdorimin e tekstit :

Shënohen porositë që do t'u jepen nxënësve lidhur me studimin që do t'i bëjnë ata tekstit mësimor (do ta mësojnë të gjithë mësimin, disa pjesë të tij, apo vetëm do t'i përgjigjen pyetjeve etj.). Kjo detyrë mund të mos jetë me shkrim, por ajo duhet dhënë medoemos për të mënjanuar mbingarkesën e nxënësve dhe për të lehtësuar nxënien e tyre. Këtu duhet mbajtur parasysh, së pari, objektivat e kapitullit, së dyti, përshtatjet e tekstit, së treti, udhëzimet e dhëna nga MASH për eliminimin e mbingarkesës, detyrat e tjera, nga libri ose nga një fletë ushtrimesh (kjo bashkëngjitet me planin e orës së mësimit).

ORË MËSIMI

Lënda: Teknologji

Klasa-----

Tema: Teknologjia e elektricitetit si sistem teknologjik.

Qëllimet:

- Të pajisen nxënësit me njohuritë bazë të ndërtimit dhe funksionimit të sistemit elektroenergjetik.
- Të aftësohen nxënësit, për të kuptuar skemën e sistemit SEE dhe për ta ndërtuar vetë atë me të gjitha elementet.

Objektivat e arritjeve sipas niveleve relative:

Niveli bazë:

- Të tregojë rëndësinë e përdorimit të energjisë elektrike.
- Të përshkruajë të gjitha lëndët e para që përdoren për prodhimin e energjisë elektrike.

Niveli mesatar:

- Të listojë të gjitha inputet e sistemit SEE.
- Të përshkruajë të gjithë elementet e sistemit SEE.

Niveli i lartë:

- Të vizatojë skemën e sistemit SEE, duke i komentuar të gjitha elementet e tij.
- Të komentojë lidhjen e kundërt.

EVOKIMI:

1. Cilat janë problemet kryesore të STBE-ve?
2. Cilat janë rrugët për rritjen e rendimentit të STBE-ve?
3. Cilat mendoni se do të jenë burimet kryesore të energjisë në të ardhmen?

4. Pse energjia elektrike është kaq shumë e rëndësishme në krahasim me energjitë e tjera?


TEMA E RE

- Rëndësia e teknologjisë së elektricitetit.
- Lidhjet e kësaj teknologjie me shkencat, si: fizika, matematika, kimia, elektroteknika, informatika etj.
- Teknologjia e elektricitetit përfaqëson një sistem teknologjik që merret me prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe përdorimin e energjisë elektrike.
- Paraqitja skematike e sistemit SEE.

Përbërja e Sistemit SEE

1. N/sistemi i prodhimit të energjisë elektrike është i përbërë kryesisht nga sistemi turbinë-gjenerator dhe është hallka kryesore e sistemit SEE.
2. N/sistemi i transmetimit është i përbërë kryesisht nga transformatorët dhe shëben për transmetimin e energjisë elektrike nga hallka prodhuese deri tek shpërndarja.
3. N/sistemi i shpërndarjes së energjisë, pasi e zvogëlon TN në TM e shpërndan atë me anë të linjave tek NE dhe kabinat elektrike dhe më pas tek çdo përdorues.
4. Përdorimi është hallka e fundit e sistemit, ku përdoruesit e marrin energjinë elektrike dhe e përdorin atë për: ndriçim, ngrohje, gatim, argëtim e veprimtari të tjera.
5. Feedback-u apo lidhja e kundërt është sistem kontrolli brenda sistemit SEE, për ta kontrolluar çdo hallkë të tij., që defektet e ndryshme të kapen në kohë e të rregullohen sa më shpejt.

SKEMA E SISTEMIT SEE



REVOKIMI:

1. Ç'është teknologjia e elektricitetit?
2. Cilat janë hallkat e sistemit SEE?
3. Çfarë përfshin prodhimi i energjisë elektrike?
4. Cilët janë përdoruesit e energjisë elektrike?

REFLEKTIMI:

1. Cilat janë veçoritë e trasmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike?
2. Përse shërben lidhja e kundërt (feedback-u)?

DETYRË:

Nxënësit të sjellin foto të marra nga interneti ku të tregohet përdorimi i energjisë elektrike në jetën e përditshme.

VLERËSIMI:

- Përgjigjet e nxënësve, gjatë Evokimit vlerësohen nga ana e mësuesit, sipas nivelit të përgjigjes.

Por, nuk është vetëm ky momenti i vlerësimit të nxënësve:

- - Gjatë trajtimit të temës së re, kur nxenesit aktivizohen apo plotësojnë diçka, p.sh., tek hallka prodhuese mesuesi kërkon që vetë nxënësit të tregojnë inputet e prodhimit të energjisë elektrike dhe ata përgjigjen, duke i përmendur të gjitha lëndët e para që përdoren në sistem.
- - Apo kur duhet të përmendim përdorimet e energjisë elektrike, vetë nxënësit përgjigjen për të gjitha rastet e përdorimeve shtëpiake apo industriale.
- - Kur vetë nxënësi, pasi është trajtuar plotësisht tema e re, dëshiron të vijë në tabelë dhe ta vizatojë vetë skemën e sistemit SEE, duke e komentuar atë.
- - Nxënësi vlerësohet edhe për materialin që ka sjellë, lidhur me temën e re apo temën e kaluar, të cilën e komenton para klasës, duke theksuar anën shkencore apo një arritje të kësaj fushe.
- - Nxënësi tregon shndërrimet e energjisë elektrike në llojet e tjera të energjisë, duke i konkretizuar ato me shembuj, në bazë të njohurive të marra më parë.

* * * * *

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

UDHËZUES KURRIKULAR
(MATERIAL NDIHMËS PËR MËSUESIT E GJIMNAZIT)

LËNDA: TIK

TIRANË, 2010

PËRMBAJTJA :

1.RËNDËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT NË KURRIKULËN E RE TË GJIMNAZIT

1.1 Synimet e kurrikulës së re

1.2 Zhvillimi i aftësive

1.3 Fusha dhe përmbajtja

1.4 Mundësitë kurrikulare për integrimin e lëndës TIK me lëndët e tjera

1.5 Zbërthimi i objektivave të programit në objektiva specifike sipas niveleve të arritjes nga nxënësit

2.METODOLOGJIA DHE MJETET MËSIMORE PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS

3.VLERËSIMI I NXËNËSIT

1. RËNDËSIA E TEKNOLOGJISË SË KOMUNIKIMIT DHE INFORMACIONIT (TIK) NË KURRIKULËN E RE TË GJIMNAZIT

Përdorimi i teknologjisë së komunikimit dhe të informacionit gjithnjë e më shumë në të gjitha aspektet e shoqërisë, bën të rëndësishëm futjen e TIK-ut si një lëndë me rëndësi të veçantë.

Kjo bën të mundur që përdorimi produktiv dhe i besueshëm i TIK-ut të trajtohet si një mundësi thelbësore për jetën. Kjo lëndë përfshin jo vetëm mjeshhtërinë e aftësive teknike, por edhe kuptueshmërinë për të zbatuar dhe aplikuar këto aftësi në jetën e përditshme, deri dhe në punësimin e nxënësve, menjëherë pas përfundimit të gjimnazit.

TIK-u u krijon mundësi nxënësve të marrin pjesë dhe të angazhohen në shoqërinë bashkëkohore.

Kjo lëndë është ndërtuar duke marrë parasysh dëshirat dhe aftësitë përvetësuese të nxënësve të moshës 15-18 vjeç.

Në këtë lëndë duhet të ketë parasysh këto parime bazë:

- Të mundësojë për të modeluar situata dhe për të zgjidhur probleme të ndryshme, duke kaluar nga më e lehta, tek më e vështira.
- Të veprojë si një forcë e fuqishme, për të sjellë përdorimin e TIK-si shoqëri.
- Të mundësojë hyrje të shpejtë të ideve dhe përvojave nga një rang i gjerë njerëzish, komunitetesh dhe kulturash, që nxënësit të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë informacione në një masë të gjerë.
- Të mundësojë përf forcimin e nismës dhe të pavarësisë në të mësuarit e kësaj lënde, për të bërë gjykime të menduara mirë, se kur dhe si do të përdoret TIK-u.

1.1 Synimet e kurrikulës së re

Në kurrikulën bërthamë lënda e TIK-ut synon të sigurojë një formim të përgjithshëm të njohurive të nevojshme për të përdorur mjetet, pajisjet, programet e kompjuterit për të plotësuar nevojat e përdoruesit dhe për të zgjidhur probleme. Gjithashtu, synon të ndikojë mbi individët, ko-

munitetet dhe shoqërinë, duke marrë parasysh implikimet (ndërlikimet) sociale, ekonomike, ligjore dhe etike për përdorimin e TIK-ut. Të arrihet suksesi në nxënie gjatë gjithë shkollës deri në përgatitjen e aftësive për t'u përballur me tregun e punës në mbarim të gjimnazit, ose për të vazhduar universitetin në shkencat e TIK-ut.

Konceptet kryesore, struktura dhe përmbajtja që përfshijnë lëndën e TIK-ut, do t'u japë nxënësve mundësinë të njihen me zhvillimin e sotëm shoqëror dhe rolin e kompjuterit në të, shfrytëzimin e tyre dhe lehtësitë që ofrohen nëpërmjet programit të TIK-ut.

Këto ishin të mjaftueshme për një nxënës, i cili mund të quhet shumë drejt përdorues i mirë i kompjuterit, por ama nuk e kompletojnë atë aq sa duhet me formimin e tij në Informatikë këtë problem e zgjidh kurrikula e lëndës TIK me avancim.

Konceptet kryesore që do të merren gjatë zhvillimit të lëndës TIK, tashmë e kanë plotësuar këtë lëndë në gjithë shtrirjen e saj. Nxënësi nuk do të mbetet vetëm me njohuritë e pjesëve të kompjuterit dhe të përdorimit të tyre, por edhe me njohjen e aplikacioneve, siç janë zbatimi i programeve të internetit dhe e-mailit, si dhe programet e paketës Microsoft Office, me identifikimin e problemeve të zakonshme lidhur me përbërësit kompjuterikë.

Në programin e TIK avancim për klasën e dymbëdhjetë rëndësi i kushtohet përdorimit të programeve të Web Design, faqosjes dhe multimedias. Të tria këto fusha janë sot boshte të Informatikës dhe realizohen nëpërmjet futjes së programeve të reja, si Macromedia Dreamweaver, Html, Javascript, CSS, Adobe Photoshop dhe Illustrator, dhe Windows movie maker. Disa nga këto programe janë ato që përdoren më shumë sot në profesionin e Informaticienit jo vetëm në Shqipëri, por në gjitha vendet e tjera.

Futja për herë të parë në programin e klasës së njëmbëdhjetë të softwarit, siç është softi Microsoft Publisher, i dha mundësi nxënësit të njohë teknikat e faqosjes dhe të krijimit të websiti të thjeshtë, kurse soft-waret që ofrohen në lëndën me zgjedhje të TIK klasa e dymbëdhjetë e afron nxënësin më shumë me mjedisin e Web design dhe multimedia duke i dhënë mundësi që të kompletohen në këto drejtime.

Nxënësit gjatë zhvillimit të lëndës do të njihen dhe me disa karakteristika të aspektit të programimit, siç janë variablat, zona e zbatimit të tyre, metodat e gjuhëve të programimit e të tjera. Këto nuk janë të vështira dhe nuk e demoralizojnë nxënësin, përkundrazi, ato i japin mundësi atij të njohë disa koncepte për programimin Web dhe multimedian.

Nxënësit duke realizuar objektivat e programit do kenë mundësi në fund të nxjerrin një produkt multimedial, i cili mund të jetë një Website ose një kontent multimedial, çka kjo mund të jepet si detyrë përfundimtare dhe mund të jetë vetjake ose në grupe.

Përdorimi i kontentit të multimedias, krijimi i kontaktit me teknika të ndryshme dhe manaxhimi i tyre, paraqitja e prezantimeve që përmbajnë tekst, audio dhe video, lidhja me videoprojektorin në klasë duke e bërë më tërheqëse dhe duke dhënë më mundësi për angazhimin e gjithë nxënësve në mësim, përbëjnë një mundësi që këto programe ofrojnë. Duke u nisur nga fakti që këta nxënës janë në vit të fundit në gjimnaz dhe mund të kenë dëshirë të vazhdojnë Informatikën, këta software i japin një mundësi të mirë dhe paraprake për ambientimin në fushën e teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit, pasi do jenë vetë të aftë t'i kryejnë paraprakisht këto brendi dhe prezantime multimediale.

Koncepti mbi përdorimin e internetit futet që në klasën e dhjetë për vetë faktin se tashmë nxënësit tanë janë familjarizuar me të në një moshë më të vogël. Jo vetëm eksplorimi në internet, por edhe përzgjedhjet e sigurisë, konfigurimi, kërkimi, shkarkimi nga interneti, shërbimet në internet etj., do të plotësojnë gamën e njohurive në klasën e dhjetë në lëndën e TIK-ut.

Të gjitha këto koncepte duhet të përfshijnë përdorimin e kërkesave gjithnjë e në rritje të problemeve, situatave dhe informacionin kompleks, nga një rang i gjerë burimesh dhe një shumëllojshmëri kontekstesh.

Në klasën e njëmbëdhjetë nxënësve u ofrohej gjithashtu dhe një gjuhë programimi e mirëfilltë, siç ishte C++, por gjithmonë duke vendosur objektiva jo shumë të vështirë për nxënësin dhe vetë objektivat të ishin të ndarë në nivele brenda tyre, dhe kjo ishte një tjetër hap plus në kuadrin e formimit të tyre informatik, mbetej vetëm softwerët që merreshin me design web dhe faqosje dhe krijim përmbajtjesh multimedialë, me shtimin në program të softeve, si Macromedia Dreamweaver, Html, Javascript, CSS, Adobe Photoshop dhe Illustrator dhe Windows Movie Maker nxënësit kompletohen me njohuritë e tyre për fushën e teknologjisë dhe informacionit.

Struktura e re e kësaj lënde shfaqet që në numrin e orëve mësimore, 34 orë vjetore, meqenëse është lëndë në vitin e fundit në gjimnaz ka më pak orë se TIK-u në klasën e njëmbëdhjetë me zgjedhje, por programi i lëndës është ndërtuar i tillë që të ketë në përmbajtje linja dhe nënlinja me një vizion të plotë dhe të kompletuar lëndor për software-et e sipërmendur. Orët e lira zënë një masë prej 10% të orëve të përgjithshme, ku mësuesit

i lihet mundësi e lirë për shfrytëzimin e tyre për të ndërtuar më mirë kontrollin, vlerësimin dhe prezantimin e çdo nxënësi në këtë lëndë.

Nxënësi duhet të përsosë jo vetëm përdorimin e programeve bazë, si Word, Access, Excel, PowerPoint, Internet Explorer dhe me Publisher, që janë bërë në kurrikulën bërthamë dhe mundësojnë formimin e tij bazë në përdorimin e kompjuterit, por për nxënësin, i cili zgjedh avancim duhen thelluar objektivat dhe kërkesat ndaj tij, duke kërkuar prej tij të përdorë softëare më specifike dhe më profesionale në drejtim të fushës së teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit.

TIK-u në tërë strukturën e saj u përgjigjet të gjitha nevojave të nxënësve pavarësisht nga prejardhja, njohuritë fillestare, interesat arsimore etj., duke mundësuar që çdo nxënësi të bëjë përzgjedhjen e vet në lidhje me interesat dhe karrierën e tij.

Vetë lënda TIK-u me avancim klasa e dymbëdhjetë nuk kërkon domosdoshmërisht që nxënësi të ketë zgjedhur dhe në klasën e dhjetë dhe njëmbëdhjetë si lëndë me zgjedhje TIK-un. Ai mund të mos ketë zgjedhur lëndën TIK të avancuar më përpara dhe shumë mirë mund të zgjedhë lëndën TIK i avancuar për klasën e dymbëdhjetë pa pasur frikë se do ketë mangësi ose boshllëqe.

Vetë kurrikula e lëndës TIK 12, është ndërtuar në mënyrë të tillë që të jetë zgjerim dhe jo thellim i koncepteve dhe programeve të dhëna në klasën paraardhëse, duke pasur si përmbajtje software (programe) të ndryshëm nga ata që nxënësit kanë mësuar në klasat e mëparshme.

Kjo ka dy përparësi:

1. Nxënësit njihen me programe të reja dhe që përdoren aktualisht, duke qenë koherente me zhvillimet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.
2. Nxënësit të cilët nuk kanë zgjedhur modulet e mëparshme të TIK avancim në klasat e njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë mund ta zgjedhin lëndën TIK dymbëdhjetë pa pasur druajtje ose frikë se do kenë mangësi në mësimin e saj.

Nxënësi duhet:

- të kryejë hulumtime, kërkime praktike, si dhe të integrojë gjetjet në projektet lëndore, si në matematikë, kimi, fizikë, teknologji, duke qenë koherente me zhvillimin e shkencës dhe të teknologjisë;
- të përdorë një gamë mjetesh informacioni dhe komunikimi në prezantimin e projekteve lëndore në lëndë të ndryshme;

- të krijojë faqe të formateve html/htm, ose flash, të cilat mund të jenë të pajisura me elemente që kanë interaktivitet dhe ndryshueshmëri me përdoruesin.
- të krijojë kontentin (përmbajtjen) multimediale në format video ose lloj tjetër, i cili ka si përmbajtje tekste, slide, muzikë, animime (gjallëruese) dhe efekte vizive (pamore).
- të krijojë kopertina, fletpalosje, logo (pjesë, copa) të llojeve të ndryshme (ose nga fillimi ose duke përdorur template (shabllone) të gatshme të instaluar në software ose të downloaduara (shkarkuara) nga Interneti), duke përdorur programin Adobe Illustrator.
- të hartojë dhe të përpilojë tabela dhe grafikë statistikore duke i përfshirë jo vetëm në lëndën e TIK-ut, por edhe në lëndën e matematikës, ekonomisë, sociologjisë, gjeografisë etj.;
- të parashikojë dhe të zgjidhë situata problemore të thjeshta në matematikë e fizikë nëpërmjet gjuhëve kompjuterike të programimit që mëson, siç është gjuha C++;
- të krijojë mundësi të modelojë situata dhe të zgjidhë probleme të ndryshme;
- të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacione, duke përdorur mjetet e komunikimit, siç është e-maili dhe interneti.

Të gjitha këto produkte të rezervohen në kompjuterat e laboratorit dhe të shërbejnë ose të përdoren në klasat pasardhëse si modele guide ose krahasimi për përmirësime të mëtejshme.

TIK do të jetë një mjet i fortë në duart e nxënësve për të qenë më të saktë në atë që ata studiojnë, për të qenë më racionalë dhe praktikë në çdo studim apo kërkim.

Përmbajtja e kurrikulës së re të TIK-ut është zhvilluar në një shtrirje racionale midis kurrikulës bërthamë dhe asaj të avancuar, duke u menduar si një zgjerim në njohuri dhe koncepte të kurrikulës së avancuar të klasave të mëparshme.

Përmbajtja e gjithë lëndës është realizuar që nxënësi të marrë jo vetëm njohuritë bazë të informatikës, por të realizojë mundësinë që ai të jetë i aftë të aplikojë për marrjen e çertifikatave kombëtare dhe ndërkom-bëtare të informatikës.

Këto mund të jenë çertifikata bazë të përdorimit të kompjuterit, si p.sh., ECDL core, ose Microsoft, por dhe të niveleve të avancuara, duke u testuar për software specifike nga ata që janë në kurrikulën e avancuar.

Në kurrikulën bërthamë synohet që nxënësi:

- Të sigurojë një formim të përgjithshëm për programet që përdoren sot nga përdoruesit e pc;
- të ndjekë dhe të kuptojë nevojat për praktika të sigurta;
- të pajiset me aftësi të nevojshme për të njohur kompjuterin dhe pjesët përbërëse të tij, në të njëjtën kohë edhe për të njohur konceptet dhe për të fituar njohuri në programet kryesore të pc, që përdoren sot më shumë për t'u dhënë mundësinë nxënësve që të zgjerojnë njohuritë jashtë programit pa ndër vështirësi;
- të fusë, zhvillojë, formatojë, përpunojë informacionin në mënyrë të pavarur, që të përshtasë kuptimin dhe qëllimin e tij;
- të lidhë informacionin për t'iu përshtatur përmbajtjes dhe qëllimit;
- të vlerësojë zgjedhjen dhe përdorimin e mjeteve të TIK-ut dhe lehtësimeve për të prezantuar informacionin;
- të shfrytëzojë internetin për kualifikim dhe vetëkualifikim;
- të sigurojë të dhënat dhe mbrojtjen e kompjuterit nga viruset dhe programe të tjera të rrezikshme, nga ndërhyrje të paautorizuara;
- të njihet me mënyrat e reja të transmetimit të informacionit përmjet rrjetave, si interneti apo rrjetave vendore workgroup, siç mund të jenë teknologjitë (wireless, bluetooth etj.);
- të hartojë dhe të realizojë njoftime, fletëpalosje, logo, kalendarë, webpage etj. nëpërmjet programit Microsoft Publisher;
- të instalojë dhe të manipulojë template (shabllone) të gatshme online etj.

Pra, janë të gjitha ato karakteristika, të cilat përmbledhin basic literacy for ICT (aftësinë e shkallës bazë të arsimimit), kurse kurrikula e avancuar, e cila fillon që në klasën e 10-të me Web design, duke përdorur softwarin Web Expression dhe programin Adobe Photoshop dhe fotografi si kurrikulë me zgjedhje të lirë, pastaj vijon në klasën e 11-të me pak futje në programim, siç është gjuha C++. Kjo shtrirje përfundon në klasën e dymbëdhjetë të gjimnazit me software të rinj dhe user friendly.

Në programin e lëndës së avancuar nuk janë specifikuar versionet e softwareit që do përdoren, por vetëm emërtimi i tyre. Kjo është bërë për arsye të thjeshtë se objektivat e programit të lëndës TIK i avancuar janë vendosur në mënyrë të tillë që të realizohen në kuadër të çdo versioni të këtyre softwareve pa i kushtëzuar në serinë e tyre. Dihet që softwaret me

versionet e reja që krijohen janë një përmirësim i softëareve ekzistues të mëparshëm, dhe kanë ato funksionalitet që kanë softëarët e mëparshëm, mund të kenë funksione shtesë, por asnjëherë më pak, prandaj nuk përbën problem mosshënimi i versionit të softëarit që do përdoret, sepse ai softëare në çdo version të tij i ofron realizimin e objektivave të programit të lëndës TIK i avancuar.

1.2 Zhvillimi i aftësive

Aftësia në përdorimin e TIK-ut përforcon nismën dhe pavarësinë e të mësuarit, duke u ofruar mundësia të bëjnë gjykime të menduara mirë, të krijojnë punë duke përdorur dhe fantazinë e nxënësit, pra duke mos i kufizuar në detyrat dhe ushtrimet që jep mësuesi, por duke pasur një larmi dhe të gjitha këto ndihmojnë për të përmirësuar cilësinë e rezultateve të punës së nxënësit.

Disa nga aftësitë që zhvillohen gjatë studimit dhe mësimit të lëndës TIK i avancuar për klasën e dymbëdhjetë janë aftësitë e të menduarit kritik dhe krijueshmëria.

Të menduarit kritik është përdorimi i arsyes për të marrë një vendim, për të zgjidhur një problem. Gjithashtu vetë programi i lëndës i ofron nxënësit mënyrën se si të zhvillojë aftësitë analizuese. Nxënësi njihet me probleme, të cilat janë të lidhura me probleme të tjera, në mënyrë horizontale ose vertikale, pra që varen nga ato siç mund të jenë, për shembull, cascading style sheet në CSS, ku përdorimi i tyre ndikon në gjithë faqen e websitit, dhe nxënësi analizon nëse një klasë CSS do ta përdori në gjithë websitin apo vetëm në faqe të caktuara ose dhe vetëm në një pjesë të faqes. Pra, mendimi kritik dhe analiza janë dy aftësi, të cilat nxënësit do ti zhvillojnë gjatë mësimit të lëndës TIK i avancuar. Por nuk janë vetëm këto aftësi, një element tjetër është krijueshmëria. Nxënësit përdorin softëare të cilët kanë shumë mënyra për realizimin e një objekti, duke i dhënë kështu mundësi imagjinatës krijuese të vetë nxënësit. Po marr si shembull krijimin një minifilmi, duke përdorur programin Windows Movie Maker. Ky program ofron mundësinë e montazhit, duke bashkuar në një skedar të tipit wmv (windows media video) elemente të ndryshme, si figura (pictures), element zanor (audio), që mund të jetë muzikë, zë i regjistruar nga një aparat incizues dhe i hedhur më pas në kompjuter dhe tekst (text), të cilat mund të shërbejnë si titra ose elemente plotësuese, zburuese gjatë filmit. Mësuesi mund t'u japë detyrë nxënësve të realizojnë një film duke përdorur audio, tekst dhe figura dhe ta shoqërojnë kalimin nga figura në

figurë me elemente të bukura, siç janë video transition dhe video effects. Nxënësi i realizon të tëra elementet e detyrës së dhënë, duke përmbushur kështu objektivin e programit, ndërkohë nxënës të tjerë e përmbushin po këtë objektiv në të njëjtin nivel, duke kryer video transition dhe video effects sipas dëshirës dhe imagjinatës së tyre, sepse vetë softwari i ofron këto mundësi zgjedhjeje të ndryshme.

Aftësitë që fitohen nëpërmjet TIK-ut, si dhe zhvillimi i tyre realizohet nëpërmjet disa koncepteve.

Së pari:

Nëpërmjet përdorimit të pajisjeve të TIK-ut në mënyrë sa më të qëllimshme për të shqyrtuar dhe për të zgjidhur pyetje dhe probleme, duke krijuar ide dhe vlera zgjidhjeje.

Manaxhimi i informacionit, marrja nga burime të ndryshme, vlerësimi i tij, përpunimi i tij.

Zbatimi i TIK-ut në një sërë aspektesh sidomos në atë të të mësuarit, të punës dhe të jetës.

Së dyti:

Komunikimi dhe bashkëpunimi me:

Eksplorimin e mënyrave që TIK-u mund të përdoret për të komunikuar bashkëpunuar.

Mënyrat për shkëmbime idesh për të bashkëpunuar në grup me mënyra të reja.

Së treti:

Zbulimi i ideve dhe përpunimi i tyre në mënyrë sa më kreative (krijuese).

Zgjidhja e problemeve në mënyrë krijuese, duke përdorur TIK-un për të zbuluar ide dhe për të provuar alternativa.

Kujdesi ndaj paragjytimeve, anësisë dhe keqinformimit.

Të shprehë me sa më shumë forma origjinalitetin e vet në shkollë, në komunitet dhe në punë.

1.3 Fusha dhe përmbajtja

Përmbajtja i referohet lëndës, paraqitjes së saj, shfrytëzimit të linjave për të prezantuar informacionin dhe integrimin e tij nëpërmjet ideve dhe fakteve.

Lënda Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit do t'u sigurojë nxënësve njohuritë më të nevojshme dhe më kryesore për të përdorur kompjuterin, programet e Microsoft Office, shfrytëzimin e internetit dhe postës elektronike, efektin e kompjuterit në shoqëri dhe disa koncepte për algoritmikë dhe programim. Nxënësi do të jetë i aftë të përdorë kompjuterin në mënyrë efektive, të zbulojë dhe të zhvillojë të gjitha mundësitë dhe bazat e nevojshme për rritjen e produktivitetit dhe arritjen e marrjes së certifikatave ndërkombëtare të kompjuterit.

Lënda është e ndërtuar në formën e linjave dhe me orët e sugjeruara për secilën linjë.

Secila linjë ka të përshkruar me saktësi dhe qartësi objektivat, si dhe përshkrimin e linjës.

Mësuesit i jepet një liri veprimi në hartimin e planit sintentik dhe tematik. Në përputhje me nivelin dhe interesat e nxënësve, mësuesi harton planin mësimor brenda orëve të caktuara për secilën linjë.

Duke përshkruar me saktësi objektivat e arritjeve të nxënësve për çdo linjë, mësuesi arrin të hartojë e të ngrejë gjithë punën e tij me një vizion të qartë dhe të matshëm në përputhje me nivelin e nxënësve. Kësisoj bëhet një ndërthurje e standardeve me nivelin dhe kërkesat e nxënësve me të cilët mësuesi punon.

Në kurrikulën bërthamë lënda është e ndarë në dy drejtime bazë:

1. Hyrje në sistemin kompjuterik.
2. Formimi i shprehive, kompetencave për aplikimet dhe programet kompjuterike.

Drejtimi i parë përfundon në klasën e dhjetë, duke bërë të mundur që nxënësi të përcaktojë specifikimet dhe komponentet kryesore të sistemit kompjuterik, përdorimin e tyre, mënyrat e komunikimit dhe operimit të sistemit kompjuterik.

Drejtimi i dytë është i shtrirë në të tri klasat (e dhjetë, e njëmbëdhjetë dhe e dymbëdhjetë) me një ndërthurje të njohurive me moshën dhe kapacitetin e nxënësve. Duke parë që nxënësit sot janë shumë të interesuar në përdorimin e kompjuterit, të aplikimeve me anë të programeve

kompjuterike, lënda e TIK-ut realizon përmbushjen e interesave gjithnjë e në rritje të tyre. Këtu nxënësi fiton shprehi bazë për përdorimin e kompjuterit, duke e përdorur atë si mjet ndihmës për hulumtimin dhe kërkimin e informacionit. Pastaj, informacionin e marrë e përpunon nëpërmjet aplikacioneve, duke bërë përpunimin e tyre në varësi të situatave të ndryshme në programet kompjuterike.

Lënda me zgjedhje e TIK-ut nga ana e vet ofron një avancim në njohuri, ajo përqendrohet tek ndërtimi i faqeve të internetit, duke u dhënë mundësi nxënësve në fund të jenë të aftë të planifikojnë dhe ndërtojnë një faqe interneti.

1.4 Mundësitë kurrikulare për integrimin e lëndës TIK me lëndët e tjera

Qëllimi i integritit të aftësive teknologjike informative me lëndët dhe fushat e tjera, qëndron në aftësimin e nxënësve në përdorimin e këtyre aftësive në jetën e përditshme dhe në kuptimin e bashkëveprimit dhe ndikimit që shoqëria dhe teknologjia kanë me njëra-tjetrën.

Nëpërmjet teknologjisë së komunikimit dhe të informacionit nxënësit pasurojnë kompetencën, forcojnë vetëbesimin, nxisin nismën dhe shtojnë shprehitë për të kontrolluar sa më mirë mundësitë që ofron teknologjia e komunikimit dhe e informacionit. Përdorimi i teknologjisë së komunikimit dhe informacionit rritet nga dita në ditë. Nxënësit përmes TIK-ut aftësohen për të kërkuar informacione, për t'i zgjeruar dhe përpunuar ato dhe për t'i vënë në shërbim të punës dhe jetës së përditshme.

Nxënësit aftësohen për të bërë gjykime vetjake mbi çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetën e tyre.

TIK-u është pjesë përbërëse e jetës së përditshme. Arsyeja kryesore e zhvillimit të TIK-ut gjatë edukimit në formimin e përgjithshëm është lidhja e qëndrueshme që ajo ka me fushat dhe lëndët e tjera të kurrikulës.


Kurrikula e gjimnazit siguron njohuri, aftësi dhe qëndrime që lidhen jo vetëm me formimin e përgjithshëm TIK-ut, por edhe me punën, me arsimin profesional dhe teknik.

TIK-u DHE FUSHAT E TJERA

Shtirja e TIK-ut në kurrikul si lëndë e veçantë dhe e integruar në lëndë të ndryshme përmes përdorimit të saj nga mësuesi dhe nxënësi, në kushtet e sotme të përdorimit të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit, është domosdoshmëri për realizimin e objektivave të kurrikulës dhe të shkollimit në përgjithësi. Kjo përfshirje mund të realizohet përmes integritimit të TIK-ut në lëndë të ndryshme dhe përgatitjes së mësuesve për përdorimin e saj në klasë.

Në të gjitha fushat e të nxënit, nxënësit duhet:

- Të përdorin TIK-un për të kërkuar, gjetur informacione të nevojshme.
- Të përpunojnë, të bëjnë parashikime dhe të zgjidhin situata problemore me ndihmën e TIK-ut.
- Të paraqesin e prezantojnë punën individuale apo të grupit, duke përdorur një larmi mediash dixhitale.
- Të bashkëpunojnë me të tjerët nëpërmjet komunikimit elektronik.



Disa nga mundësitë ku TIK-u mund të ndihmojë fushat e tjera janë:

Artet: në muzikë, në efektet speciale, në artet pamore, në organizimin e çdo projekti etj.

Shkencat shoqërore: në paraqitjen e punës individuale, në analizimin e të dhënave, në komunikimin elektronik etj.

Matematika: në përdorimin e formulave dhe grafikëve, duke rritur saktësinë dhe shpejtësinë e llogaritjes dhe duke i ndihmuar nxënësit t'i kuptojnë më mirë temat etj.

Gjuha shqipe: në organizimin e informacionit, në teknika të reja të studimit dhe kërkimit të informacionit etj

Edukim fizik dhe sporte: në realizimin më efektiv të orës së edukimit fizik, duke përdorur programe që flasin për mënyrën e kryerjes së aktivitetit fizik etj.

Karriera dhe aftësimi për jetën: në përdorimin e programeve kompjuterike që kanë lidhje me zhvillimin profesional.

Gjuhët e huaja: në mësimin e gjuhëve të huaja duke përdorur pajisjet dixhitale, programet e ndryshme vlerësuese dhe kontrolluese, në përkthimet dixhitale etj.

Teknologjia: në mbështetjen e teknologjive të reja, në paraqitjen e simulimeve, në parashikimin e fenomeneve, në përdorimin e programeve kompjuterike për një rezultat sa më të saktë dhe të qartë etj.

Shkencat natyrore: në përpunimin e informacionit dhe nxjerrjen e rezultatit, në përdorimin e simulimeve etj.

TIK-u DHE LËNDËT E TJERA

Lidhja e kurrikulës me lëndët e tjera i vë nxënësit në pozita pune:

- Të analizojnë situata problemore të ndryshme dhe të hartojnë plane për zgjidhjen e tyre.
- Të monitorojnë kontrollojnë dhe vlerësojnë ecurinë e etapave të zgjidhjes së problemeve me anë të mundësive që ofron TIK-u.
- Të bëjnë parashikime, të ngrenë hipoteza, të justifikojnë në mënyrë bindëse metodat e përdorura të kërkimit dhe përfundimet e arritura.
- Të kërkojnë, të bëjnë zgjedhje të ndryshme dhe t'i vlerësojnë ato nga dobia dhe zbatueshmëria.

Aftësitë e përdorimit dhe përpunimit të informacionit i ndihmojnë nxënësit të bëhen individë më aktivë në një mjedis të pasur me informacione. Përveç zhvillimit të aftësive, mundësive, përzgjedhjes, vlerësimit dhe

regjistrimit të informacionit, nxënësit mësojnë të vlerësojnë ndryshimet ndërmjet informacionit dhe njohurive. Ata kuptojnë se pasja e informacioneve nuk garanton njohuri dhe se njerëzve u nevojiten aftësi për të krijuar nga burimet e informacionit njohuri, si personale, dhe të përbashkëta dhe, për këtë qëllim, u vjen në ndihmë lënda TIK-u.

a- OBJEKTIVAT E ARRITJES PËR KLASËN E 11^{të}

Proceset dhe zbatimi (aplikimi)

Fillimisht po paraqesim ndërmjet të tjerash klasifikimin e objektivave të programit sipas taksonomisë së Blumit.

Niveli i parë: (Bazë)

Njohja: Është riprodhim, përsëritja e emrave, rregullave, përkufizimeve. Është niveli më i ulët i dijës. Foljet që përshkruajnë këtë nivel janë: përkufizo, përshkruaj, dallo, rendit, emërto etj.

Të kuptuarit: Është aftësia për të rrokur kuptimin e materialit. Foljet që përshkruajnë këtë nivel janë: shpjego, zgjero, jep përfundime, rishkruaj, përgjithëso etj.

Niveli i dytë: (Mesatar)

Zbatimi: Është aftësia për të përdorur materialin e mësuar në situata të reja dhe konkrete. Zbatohen rregulla, metoda, koncepte, parime, ligje, teori etj. Foljet që përshkruajnë këtë nivel janë: ndrysho, njehso, provo, manipulo, përgatit, prodho, lidh, përdor etj.

Analiza: Është aftësia për ta copëtuar materialin në pjesë përbërëse. Foljet që përshkruajnë këtë nivel janë: copëto, ndaj në pjesë, dallo, seleksiono etj.

Niveli i tretë: (I lartë)

Sinteza: Është aftësia që nxënësi të formojë një të tërë duke bashkuar pjesët. Foljet që përshkruajnë këtë nivel janë: kombino, krijo, harto, organizo, planifiko, rindërto, risistemo etj.

Vlerësimi: Është aftësia për të gjykuar vlerën e një materiali, të mirën e një ideje, motivet e sjelljeve etj. Foljet që përshkruajnë këtë nivel

janë: konkludo, kritiko, arsyeto, krahaso etj.

Zbërthejmë sipas këtij klasifikimi objektivat e arritjes së një linje të përbajtjes për klasën e dhjetë. Po marrim si shembull linjën: Microsoft Excel.

Njohja dhe të kuptuarit	<ul style="list-style-type: none"> - Të identifikojë konceptet e grumbullimit dhe organizimit të të dhënave; - të identifikojë organizimin e programit në libra dhe fletë (sheets).
Zbatimi dhe analiza	<ul style="list-style-type: none"> - Të përdorë komandat kryesore të rreshtit të menuve; - të zbatojë formulat kryesore matematike për të dhënat e hedhura në tabelë; - të krijojë tabela në sheet (fletë) të ndryshme, të cilat janë të lidhura me paste link (ngjitës) dhe të zbatojë formulat e ndryshme; - të krijojë grafikë, duke u bazuar në të dhënat e paraqitura; - të përdorë komandën filtër në gjetjen e informacionit; - të rezervojë materialin e excelit me fjalëkalim.
Sinteza dhe vlerësimi	<ul style="list-style-type: none"> - Të organizojë të dhëna në formate të ndryshme, me qëllim studimi dhe printimi.

1.5 Zbërthimi i objektive të programit në objektiva specifike sipas niveleve të arritjes nga nxënësit

Objektivat e arritjes të shënuar në program janë për gjithë nxënësit. Të gjithë nxënësit duhet të arrijnë objektivat e programit, por është e natyrshe që cilësia e arritjes së objektive të programit nuk është e njëjtë nga të gjithë nxënësit.

Standardet e nxënies në gjimnaz klasifikojnë 3 nivele arritjeje të objektive të arritjes nga nxënësit: niveli bazë, niveli mesatar, niveli i

lartë.

Duke u nisur nga objektivat e programit, përcaktohen objektivat specifikë të arritjes sipas kategorive: niveli bazë, niveli mesatar, niveli i lartë.

Niveli i lartë i arritjes ka objektiv specifik vetë objektivin e programit, objektivi specifik në nivelin bazë përshkruan një arritje të pjesshme të kufizuar të objektivit të programit dhe objektivi specifik i nivelit të mesëm përshkruan një arritje afër objektivit të programit. Po marrim si shembull objektivat e linjës Microsoft Excel.

Linja: Microsoft Excel

Objektiva të njohjes dhe të të kuptuarit

	Nxënës/i,-ja duhet:	Nxënës/i,-ja duhet:
Objektivi i programit	- Të identifikojë konceptet e grumbullimit dhe organizimit të të dhënave.	- Të identifikojë organizimin e programit në libra dhe fletë (sheets).
Niveli bazë	- Të identifikojë si t'i organizojë këto të dhëna, p.sh., ku do vendosen të dhënat, ku do të vendosen formulat, formatimi që u duhet bërë të dhënave të ndryshme në një tabelë sipas llojit (tekst, numër, monedhë, orar) ose shteete të ndryshëm.	- Të dallojë termat, faqe pune, libër pune dhe të kuptojë përdorimin e tyre.

<p>Niveli i mesëm</p>	<p>- Të identifikojë mënyrat e organizimit të të dhënave jo vetëm duke i hedhur manualisht nga tastiera, por dhe duke i marrë nga burime të tjera, sheet të tjerë, dokumente të tjera nga programe të ndryshme, dhe t'i formatojë këto të dhëna me bordura, me ngjyra, me emërtime e sheet.</p>	<p>- Të organizoj informacionin në sheet të ndryshëm, duke shtuar ose hequr sheet.</p>
<p>Niveli i lartë</p>	<p>- Të dallojë të gjitha mënyrat e kompjuimit të të dhënave (teskt, numra, formula) nga sheet ne sheet, me copy- paste, copy - paste special, dhe më pas t'i formatojë tabelën në mënyrën që paraqitja të jetë e rregulluar dhe e bukur për syrin.</p>	<p>- Të lëvizë të dhënat nga sheet të ndryshëm ose midis workbook, duke i kopjuar ose zhvendosur ato. Të bëjë ndarjen e dritares së punës split, ose 2 dritare workbooku t'i bëjë Tile windows vertically, ose Tile windows horizontally.</p>

Objektiva të zbatimit dhe analizës

	Nxënës-,i/ja duhet:	Nxënës/i,-ja duhet:
<p>Objektiva të programit</p>	<p>- Të zbatojë formulat kryesore matematike për të dhënat e hedhura në tabelë.</p>	<p>- Të krijojë grafikë duke u bazuar në të dhënat e paraqitura.</p>
<p>Niveli bazë</p>	<p>- Të kuptojë sintaksën e formulave, si fillon formula, kuptimin e: (dy pikave), përdorimin e kllapave.</p>	<p>- Të krijojë grafikë me të dhënat të cilat i selekton (zgjedh) në faqen e punës.</p>

Niveli i mesëm	- Të zbatojë formula të tipit mbledhje, zbritje, shumëzim, pjesëtim, mesatare. Ti zbatojë këto formula ose duke i shkruar nga tastiera ose duke përdorur funksionin fx dhe t'i vendosë të dhënat në dritaren e tij.	- Të krijojë grafikë të tipeve të ndryshëm për të dhënat që ka në faqen e punës.
Niveli i lartë	- Të zbatojë formula të vështira, siç janë formula me kushte, countif, if, sumif etj., duke përdorur dritaren e funksionit fx ose duke i shkruar nga tastiera.	- Të krijojë grafikë të tipave të ndryshëm duke ndjekur wizard-in për krijimin e grafikëve dhe duke e kompletuar me titull, legjendë, ngjyra, bordurë etj.

2.METODOLOGJIA DHE MJETET MËSIMORE PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS

Metoda a punës në lëndën e TIK-ut është pak më specifike dhe e veçantë sesa në lëndët e tjera. Ndryshe nga shumica e lëndëve të cilat bazohen vetëm në tekst, TIK-u kërkon domosdoshmërisht për realizimin sa më efektiv dhe një përfitim maksimal për nxënësit, edhe aplikimin praktik të njohurive të marra gjatë mësimin, duke përdorur pajisjet dixhitale. Sigurisht, kjo shoqërohet me përdorimin e kompjuterave në laboratorët përkatës në shkollë, me përdorimin e një laptopi (kompjuter portativ) dhe videoprojektori në klasë në varësi të situatës, duke u shoqëruar me prezantime, shpjegime, diskutime, simulime programesh, video, debate, shkëmbim idesh etj., në lidhje me orën e mësimin.

Përzgjedhja e metodave mësimore në lëndën e TIK-ut është në kompetencë të mësimdhënësit. Ajo bëhet në përshtatje me veçoritë e përmbajtjes së temave dhe të njësive mësimore, nivelit të formimit të nxënësve, si dhe në përshtatje të moshës dhe aftësive të nxënësve.

Me qëllim të nxënies cilësore dhe arritjes së rezultateve optimale, gjatë procesit mësimor sugjerohen këto metoda dhe teknika në lëndën e TIK-ut:

- Shpjegimi dhe sqarimi në klasë,
- demonstrimi (zbatimi) dhe interpretimi në kompjuter,
- përdorimi i pajisjeve të tjera dixhitale,
- puna në grupe e nxënësve,
- diskutimi i situatave problemore,
- vetëhulumtimi (kërkimi nga ana e nxënësve të materialit të duhur në internet),
- puna e pavarur e nxënësve,
- projektet e ndryshme që kanë realizuar nxënësit ose grupe nxënësish në bashkëpunim,
- kontrolli dhe përsëritja sistematike.

Të gjitha këto rrugë metodike u sigurojnë nxënësve marrjen e dijeve në mënyrë të plotë, efektive dhe praktike, njëkohësisht e sigurojnë mësuesin se ai i ka përdorur të gjitha mjetet e mundshme për një mësimdhënie sa më të kompletuar.

Nxënësi nuk duhet vetëm të riprodhojë dhe kuptojnë dijet e nxëna nga shpjegimi i mësuesit, por duhet të kalojë në faza më të larta, duke analizuar dhe krijuar zgjidhje akoma më të mira ose efikase për të njëjtën situatë, meqenëse lënda e TIK-ut e ofron këtë mundësi.

Kompjuterat e sallës laboratorike duhet të përdoren si mjete mësimdhënieje në mbështetje të objektivave të lëndës kur ata janë mjeti më i mirë për efikasitetin e mësimdhënies. Duhet pasur parasysh, gjithashtu, shpeshësia e përdorimit të kompjuterave në laborator në varësi të përmbajtjes së linjave që ka programi. Duke u nisur nga fakti se programi i TIK-ut përfshin në pjesën më të madhe të orëve të tij aftësimin praktik, mësuesi duhet të bëjë përdorim sa më rezultativ të sallës së kompjuterave. Mësimdhënia mund të shoqërohet dhe me ndihmën e videoprojektorit dhe laptopit në varësi të situatave, p.sh.: shpjegimit të temës mësimore, paraqitjes së materialeve të përgatitura nga nxënësit individualisht ose në grup, kryerjes së provimeve ose testeve me alternativa. Në këtë mënyrë, gjithë nxënësit përqendrohen te videoprojektori; të gjithë ndjekin hap pas hapi mënyrën e realizimit pa humbur kohë, duke punuar në kompjuterin përkatës; pyetjet që kanë, dëgjohen nga të gjithë dhe mësojnë më efektivisht.

Pra, në varësi të arritjes së objektivave të lëndës, mësuesi vendos nëse do të përdorë vetëm sallën e kompjuterave, sallën setin laptop vid-

eoprojektor, apo do ta zhvillojë mësimin vetëm me videoprojektorin dhe laptopin.

Ora e mësimit mund të organizohet e tillë që nxënësit të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.

Mund të ketë shumë përfitime nga bashkimi i nxënësve në grupe bashkëpunuese.

Meqenëse është thuajse e pamundur që mësuesi të organizojë klasën në mënyrë të tillë që të ketë mundësi të kontrollojë njohuritë e çdo nxënësi gjatë çdo ore mësimore, mënyra e organizimit të nxënësve në grupe, është një metodë e vlefshme për mësimnxënien dhe kontrollin e njohurive të tyre.

Nxënësit mund të grupohen (organizohen) në grupe homogjene ose heterogjene bazuar në disa kritere, siç mund të jenë: niveli i nxënësit, vëmendja, gjinia ose kritere të tjera.

Duke u nisur nga fakti që mësuesi duhet t'i vendosë nxënësit në kompjuter të organizuar në grupe, duke u kushtëzuar nga numri i kompjuterave për nxënës, më poshtë po paraqesim disa përparësi dhe mangësi lidhur me grupimin e nxënësve kur punojnë në kompjuter.

Kriteri i grupimit	Tipi	Përparësia	Mangësia
Nxënës të mirë / nxënës të dobët	Heterogjen (nivele të ndryshme).	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mundësi më e madhe për të mësuar dhe përfituar nga njëri-tjetri. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nxënësit më pak të mira nuk janë aktivë. ▪ Puna e vështirë bëhet nga nxënësit e mirë dhe nxënësit e dobët nuk punojnë.
Nxënës të mirë / nxënës të dobët.	Homogjen (i njëjti nivel).	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nxënësit tentojnë të lidhen dhe komunikojnë më efektivisht; ▪ Nxënësit e mirë përparojnë shpejt dhe i tejkalojnë objektivat e lëndës mësimore. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Grupet më pak të mirë mbeten pas, nuk përparojnë dhe nuk përfitojnë sa grupet e nxënësve të mirë.

Në shumicën e rasteve është mirë që këto grupime të paracaktohen para se të fillojë ora e mësimit dhe të mbeten të pandryshuara, në mënyrë që të mos humbasin kohë me shpërndarjen e nxënësve në klasë, por mësuesi mund t'i ndryshojë në varësi të ecurisë së grupimit.

Gjatë ndarjes në grupe, duhen pasur parasysh dhe konfliktet që mund të kenë nxënësit midis tyre, duke i shmangur këto gjatë caktimit të tyre në grupe.

Në shumicën e rasteve, grupet heterogjene janë të rekomanduara.

Duhet pasur parasysh se për nxënësit e nivelit të lartë mund të jepen detyra më të vështira ose detyra në situata të reja, të cilat mundësojnë rritjen e angazhimit nga ana e tyre duke eliminuar monotoninë dhe humbjen e interesit që vjen nga ushtrime të përsëritura ose që zgjidhen lehtë për nivelin e tyre.

Nxënësit, të ndarë në grupe, mund të kryejnë të njëjtën detyrë ose detyra të ngjashme në varësi të temës dhe objektivave të orës mësimore.

Puna në grupe ka përcaktimet (detyrat) e veta, disa nga të cilat janë:

- Gjithsecili duhet të kontribuojë, pra rezultati përfundimtar duhet të jetë produkt i të gjithëve;
- vlerësimi për detyrën e dhënë është i njëjtë për të gjithë ose ndryshon pak;
- nxënësit zhvillohen nga ana sociale nëpërmjet aftësive të komunikimit, besimit, diskutimit, debatit, përgjegjësisë së punës në grup, pra, atyre u zhvillohen aftësitë ndërpersonale.

Një aspekt tjetër është dhe numri i nxënësve të grupit që formojnë ata në raport me numrin e kompjuterave. Më poshtë po paraqesim një tabelë me numrin e nxënësve për kompjuter, shoqëruar me përparësitë dhe mangësitë përkatëse.

Raporti nxënës/ komputer	Përparësitë	Mangësitë
Një	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nxënësi punon me ritmin e vet, nuk është i varur nga puna e të tjerëve. ▪ Është përgjegjës vetë për rezultatin e punës së dhënë. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nxënësi mund të mos jetë i aftë ta përfundojë vetë gjithë detyrën. ▪ Kjo mënyrë kërkon më shumë kohë që nxënësi ta përfundojë detyrën. ▪ Nuk inkurajon aftësitë ndërpersonale, zgjidhjen me bashkëpunim të ushtrimeve. ▪ Nuk është model real dhe botëror që përdoret në shkollat e vendeve të tjera në botë.
Dy ose tre	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mësojnë nga njëritjetri. ▪ Ndajnë përgjegjësitë duke rritur aftësitë ndërvepruese dhe bashkëpunuese. ▪ I përket modelit që përdoret në shkollat e vendeve të tjera në botë. ▪ Detyra ose projekti mbaron në kohë më të shpejtë. ▪ Ka më shumë ide për ta realizuar detyrën. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Duhet siguar që çdo pjesëmarrës ka mundësi të kontribuojë duke zgjidhur pjesën e vet të detyrës etj. ▪ Mund të ketë pabarazi në përdorimin e kompjuterit.

Katër ose më shumë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mësojnë nga njëritjetri. ▪ Ndajnë përgjegjësitë duke rritur aftësitë ndërvepruese dhe bashkëpunuese. ▪ Detyra ose projekti mbaron në kohë më të shpejtë. ▪ Ka më shumë ide për ta realizuar detyrën. ▪ Mund të përdoret në rastin e detyrave, projekteve të vështira duke patur si pjesëmarrës nxënës të përqendruar dhe efektivë. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mund të krijojë situatën e rrëmujës. ▪ Është më e lehtë për një pjesëmarrës që të mos kontribuojë. ▪ Vështirësi dhe pabarazi për përdorimin e kompjuterit nga të gjithë.
--------------------	--	--

Grupet me 2 dhe 3 nxënës për kompjuter janë më efikase.

Lënda e TIK-ut mund të shoqërohet gjatë mësimdhënies, përveç kompjuterave dhe librave, dhe me CD me tutoriale ose video shpjeguese, prezantime etj., të krijuara nga nxënësit, mësuesit ose nga burime të tjera. Mësuesit mund t'i përdorin ato në rast se janë të bindur se përdorimi e tyre parashikohet nga programi dhe ndihmon nxënësit.

Kur planifikohet mësimi, është e nevojshme që përdorimi i çdo mjeti të jetë në mbështetje (shërbim) të arritjes së objektivave të mësimin.

Në lëndën e TIK-ut mund të përdoren pajisje dhe mjete ndihmëse për të lehtësuar dhe ndihmuar në mësimdhënien dhe mësimnxënien e lëndës, të tilla mund të jenë:

Kompjuteri/Laptopi - është mjet i domosdoshëm për aftësimin praktik të nxënësve dhe për shpjegimin e mësimin. Përdorimi i tyre lehtëson dhe mësuesin për shpjegimin e lëndës, sepse nxënësit e shikojnë realisht në kompjuter mënyrën e të vepruarit, duke eliminuar fjalët e tepërta gjatë shpjegimit dhe paqartësitë që mund të lindin për ata që nuk e njohin mirë gjuhën e huaj në kompjuter (anglishten). Pavarësisht se kompjuteri është një mjet shumë i mirë për të treguar nëse nxënësi ka arritur ta kuptojë apo jo mësimin e dhënë, duhet t'i kushtohet rëndësi dhe të pyeturit teorik,

pra, nxënësi duhet t'i dijë teorikisht komandat kryesore të programeve të lëndës, funksionin e tyre dhe t'i thotë ato pa pasur nevojë që në fillim të hapë programin dhe të fillojë të kërkojë në menu, duke mos qenë i sigurt për vendndodhjen dhe rolin e tyre.

Videoprojektori është një mjet lehtësues për mësuesin sepse e ndihmon atë për shpjegimin e mësimit, ushtrimeve, prezantimeve të ndryshme, për kryerjen e përmbledhjes së koncepteve kryesore të një grupi temash ose krejt kapitulli, për kryerjen e testimit (p.sh., test me alternativa), ku nxënësit përgjigjen dhe të gjithë dëgjojnë dhe shikojnë në videoprojektor, gjithashtu nxënësit mund të shfaqin dhe të prezantojnë punët e tyre para klasës.

Binomi kompjuter videoprojektor është një mjet shumë i fuqishëm, i cili e ndihmon shumë mësuesin për realizimin e objektivave të orës mësimore.

Pajisje, e ruajtjes së të dhënave dhe komunikimit, mësuesi mund ta përdorë sipas nevojës në mësim, përveç rastit të temës mësimore që ka lidhje me shpjegimin e përdorimit të tyre. Pajisje të tilla, si: USB flash, CD-ROM, DVD etj., që i duhen për përdorimin dhe lëvizjen e materialeve, mund të përdoren sipas nevojave, por duhet të ketë parasysh dhe rrezikun që mbartin këto pajisje për viruse etj., dhe skanimin e tyre në mënyrën e duhur për eliminim e problemeve që lindin nga viruset etj.

Smartboardi ose whiteboardi është një nga mjetet më moderne në mësimdhënie. Ai përdoret shumë në botë dhe mund të jetë pjesë e mësimdhënies jo vetëm në lëndën e TIK-ut, por edhe në çdo lëndë tjetër. Ai është njësoj si dërrasat tradicionale, vetëm se në të nuk ka nevojë për shkumës, por është touchscreen, pra, përdoret me prekjen e dorës, në këtë mënyrë çdo veprim është më komod dhe më i lehtë për t'u kryer.

Printer, scanner, sigurisht këto janë pajisje të cilat ndoshta nxënësit dinë t'i përdorin, por mësuesi nuk duhet të ngurrojë të shpjegojë mënyrën e funksionimit të tyre, instalimin dhe mënyrën e lidhjes, sepse jo të gjithë nxënësit i njohin dhe i kanë përdorur. Për më tepër, ato janë pajisje që përdoren kudo nëpër zyra dhe aftësia për përdorimin e tyre përbën, gjithashtu, domosdoshmëri.

Baza materiale për mësuesin që zhvillon lëndën e TIK-ut i duhet vënë në dispozicion atij, sepse është pjesë e domosdoshme për zhvillimin e lëndës së TIK-ut.

Mësuesi duhet t'i kushtojë vëmendje punës krijuese, punës në grup, në debat, punës për zgjidhje problemash, punës kërkimore, ose aktivitetit

mbi projekte. Duke shfrytëzuar internetin në shkolla, ai mund ta plotësojë tekstin me situata dhe problema më interesante sesa ato në tekst, duke rritur kështu dhe interesin e nxënësve.

3.VLERËSIMI I NXËNËSIT

Vlerësimi në vetvete është një proces që ndihmon nxënësit dhe mësuesit.

Ç'është vlerësimi ?

- Vlerësimi është gjykimi për cilësinë.
- Vlerësimi është një mënyrë sistematike e shikimit të çështjeve tëzrëndësishme.
- Vlerësimi është sigurimi i informacionit për vendimmarrje.
- Në arsim vlerësimi shpesh lidhet me testimin dhe ngushtohet duke u kufizuar në arrijtjet e nxënësit.
- Vlerësimi është një mjet konstruktiv për përmirësim dhe risi.

Pra, vlerësimi është proces i mbledhjes sistematike, analizimit dhe interpretimit të informacionit për përcaktimin se deri në çfarë shkalle nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëzues. Vlerësimi përmban përshkrimin sasior dhe cilësor, gjykon vlerat dhe meritat, bazohet në matjen objektive, të saktë, të vlefshme, të besueshme.

Pse vlerësojmë?

- Që të dimë se në çfarë stadi, niveli, pozicioni të njohurive jemi;
- që të dimë se ku dëshirojmë të arrijmë;
- që të nxjerrim se cilat janë dobësitë, pengesat, të metat që në të ardhmen t'i evitojmë në punën tonë;
- për ta ndihmuar nxënësin të përparojë në formimin e tij;
- për të siguruar një përdorim të drejtë të vlerësimit të nxënësve;
- për të kontribuar në ngritjen e cilësisë së mësimin në bazë shkolle.

Vlerësimi mund të shihet si proces ciklik i cili realizohet përmes katër fazave:

- Në fazën përgatitore, merren vendime të cilat evidentojnë atë që do të vlerësohet, llojin e vlerësimit (formues, përmbledhës, apo diagnostikues) që do të përdoret, kriteret përkundrejt të cilave gjykohen rezultatet e të nxënësve, dhe strategjitë më të përshtatshme të vlerësimit, me të cilat mbledhet informacioni mbi progresin e nxënësve. Vendimet e marra gjatë kësaj faze përbëjnë bazat për planifikimin gjatë fazave të mëvonëshme.
- Gjatë fazës së dytë të vlerësimit, identifikohen strategjitë e informacionit të grumbulluar, ndërtohen dhe përzgjidhen instrumente, administrohen nxënësit, dhe mbledhet informacion mbi progresin e nxënësve. Identifikimi dhe eliminimi i paragjytimeve (si paragjykimet me bazë gjinore dhe kulturash) përmes strategjive të vlerësimit dhe instrumenteve të vlerësimit, dhe përcaktimi se ku, kur dhe si vlerësimi do të drejtohet, janë konsiderata të rëndësishme.
- Gjatë fazës së tretë të vlerësimit, informacioni i mbledhur gjatë fazës së mëparshme përdoret për të bërë gjykime rreth progresit të nxënësve. Bazuar në këto gjykime, merren vendime rreth progresit të të nxënësve, prindërve dhe personelit shkollor.
- Faza e reflektimit ju lejon të analizoni sukseset dhe mangësitë e fazës paraardhëse. Në mënyrë më specifike, vlerësoni vlefshmërinë dhe përshtatshmërinë e strategjive të përdorura të vlerësimit dhe merrni vendime në funksion të përmirësimit apo modifikimit të mësimdhënies dhe vlerësimit në vazhdim.

Vlerësimi i progresit të nxënësve

Me qëllim grumbullimin e informacionit rreth arritjes së objektivave nga nxënësit përzgjidhen teknikat specifike të vlerësimit. Fakti se cilat teknika përzgjidhen, varet nga ajo që mësuesit parashikojnë që nxënësit të demonstrojnë, nga aftësitë e nxënësve, dhe përpjekjet që nxënësit bëjnë në klasë. Mjedisi dhe kultura e nxënësve është gjithashtu element i rëndësishëm.

Më poshtë listohen teknikat e ndryshme të vlerësimit. Çdo mësues

duhet të ushtrojë gjykimin e tij profesional në përcaktimin e teknikave që duhet të përdorë. Nuk ka dy situata identike, kështu që dy strategji vlerësimi nuk mund të jenë identike.

Vlerësimi i nxënësit duhet të jetë pjesë integrale e praktikave më të mira të mësimdhënies. Ai duhet të trajtohet si një proces i vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës që përshkohet nga një planifikim i kujdesshëm dhe zbatim sistematik. Vlerësimi është konsideruar një element kritik që ndikon në vendimmarrjen e mësuesit dhe drejton të nxënit e nxënësve.

- **Vlerësimi** duhet të jetë pjesë integrale e praktikave më të mira të procesit të mësimdhënies dhe nxënies. Ai duhet të jetë një aktivitet i planifikuar dhe i vazhdueshëm.
- **Vlerësimi** duhet të reflektojë rezultatet e pritshme të kurrikulës.
- **Vlerësimi** duhet të përdorë teknika vlerësimi për qëllime formuese, diagnostikuese, përmbledhëse.
- **Vlerësimi** duhet të japë informacion brenda fushës njohëse, afektive dhe psikomotore.
- **Vlerësimi** duhet të jetë i drejtë, i paanshëm dhe i barabartë, duke u dhënë të gjithë nxënësve mundësinë për të demonstruar gamën e dijeve, aftësive dhe mundësive të tyre.
- **Vlerësimi** duhet të ofrojë feedback (përgjigje) pozitiv dhe mbështetës për nxënësin.
- **Vlerësimi** duhet të ushqejë aftësitë e nxënësve për të transformuar dijet e tyre në përvoja jetësore.
- **Vlerësimi** duhet të nxisë pjesëmarrjen aktive dhe vetëvlerësimin e nxënësve për të nxitur të mësuarit gjatë gjithë jetës.
- **Vlerësimi** duhet të mundësojë shanse të barabarta për zhvillimin dhe përmirësimin e nxënësve.
- **Vlerësimi** duhet të përfshijë komunikimin paraprakisht të një plani të përgjithshëm vlerësimi nga ana e mësuesit për të gjithë nxënësit. Nxënësit duhet të ndërjegjësohen për objektivat e programit dhe procedurat që do të përdoren në vlerësimin e performancës së lidhur me këta objektiva.
- Termat **vlerësim formues** dhe **vlerësim përmbledhës** janë bërë pjesë e fjalorit të përditshëm të mësuesve dhe edukatorëve qysh se Michael Scriven (Mikael Skriveni) i trajtoi këto në vitin 1967.
- **Vlerësimi formues** ka për qëllim të ofrojë informacion mbi pro-

gresin e bërë nga nxënësi si për mësuesin, ashtu dhe për nxënësin, në mënyrë që të mund të ndërmerren veprime korrigjuese, të cilat do të ndihmojnë arritjen e rezultateve të dëshiruara gjatë të nxënit.

- **Vlerësimi përmbledhës** ka për qëllim të ofrojë informacion, i cili shërben për të gjykuar rreth arritjeve të nxënësit.

- **Vlerësimi individual**

Vlerësimi individual ka të bëjë me matjet dhe gjykimin mbi progresin individual të nxënësit. Mësuesi duhet të marrë një vendim nëse progresi i nxënësit duhet të krahasohet me:

- Nivelin e tij të mëparshëm (me referencë veten).
- Me një standard të paracaktuar (referencë kriteresh).
- Duke jetësuar standardet e grupit në të njëjtën moshë ose klasë menxënësin (bazuar në norma).

- **Vlerësimi në grup**

Vlerësimi në grup është një teknikë për mbledhjen e informacionit vlerësues për punën e nxënësve në situata grupi. Mësuesi duhet të marrë një vendim lidhur me faktin nëse:

- Do të vlerësojë punën e grupit, duke i dhënë të njëjtin vlerësim të gjithë anëtarëve të grupit;
- do të vlerësojë progresin individual të nxënësit brenda grupit, duke përdorur grupin për të strukturuar nxënien, por jo për qëllime vlerësimi;
- do të vendosë nota mbi bazë grupi dhe mbi bazë individuale.

- **Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i bashkënxënësve**

Vetëvlerësimi ndodh kur nxënësit vlerësojnë punën e tyre. Vlerësimi i bashkënxënësit ndodh kur puna e nxënësit vlerësohet nga një pjesë e klasës ose nga të gjithë nxënësit e tjerë të klasës.

Nëpërmjet vlerësimit mësuesi kontrollon nivelin e nxënësve dhe gjykon arritjet dhe mangësitë e tyre, në këtë mënyrë ai përshtat orët e mësimit që të plotësojë sa më mirë këto mangësi dhe dobësi. Për nxënësin vlerësimi nuk është thjesht një kontroll që përgjithësisht përfundon me marrjen e notës, por është, gjithashtu, një mundësi që i jepet atij të dijë realisht nivelin e nxënies për njohuritë e fituara. Pra, procesi i vlerësimit është pjesë e rëndësishme që shtrihet gjatë gjithë harkut kohor të vitit shkollor. Sigurisht që ekzistojnë forma dhe teknika të ndryshme vlerësimi, të cilat mësuesi mund t'i përdorë në varësi të qëllimit se çfarë dëshiron të arrijë nëpërmjet metodës së vlerësimit.

Mësuesi duhet të përdorë dhe vlerësimin periodik, edhe vlerësimin e vazhdueshëm. Vlerësimi i vazhdueshëm mund të zbatohet me teknika të ndryshme, si p.sh.: pyetje përgjigje me gojë nëpërmjet të cilave mësuesi mund t'i pyesë nxënësit për nivele të ndryshme nxënieje, si: njohja, kuptimi, analiza, sinteza, vlerësimi.

Një mënyrë tjetër vlerësimi është zbatimi i ushtrimeve në kompjuter, nëpërmjet të cilave nxënësi demonstroi aftësitë e tij. Kjo mënyrë ofron mundësi vlerësimi për të gjitha llojet e niveleve të nxënies: njohja, kuptimi, aplikimi, analiza, sinteza, vlerësimi.

Po kështu, mund të vlerësohen detyrat e shtëpisë, të cilat mund të jenë ushtrime të kryera në kompjuter dhe që mund t'i përmbajnë të gjitha nivelet e nxënies të taksonomisë së Blumit.

Mësuesi mund të bëjë edhe miniteste, të cilat i organizon në mënyrë periodike në fund të çdo 5 ose 4 orëve mësimore. Me to mësuesi mund të kontrollojë njohuritë e nxënësve në nivelin e njohjeve dhe të kuptimit.

Prezantimet e ndryshme që mund të bëjnë studentët në grup ose vetë, duhen vlerësuar jo vetëm për përmbajtjen, por edhe për anën e tyre vizive dhe prandaj ato përfaqësojnë një mjet të mirë vlerësues për të gjitha nivelet e nxënies sipas taksonomisë së Blumit. Në këtë mënyrë nxënësit përmirësojnë dhe aftësitë ndërpersonale dhe të komunikuarit.

Mënyrë e rëndësishme vlerësimi janë edhe kontrollet periodike nëpërmjet detyrave (në klasë ose në shtëpi) ose provimeve, të cilat përmblodhin njohuritë dhe aftësitë kryesore që duhet të zotërojë nxënësi në fund të kapitullit.

- Vlerësimi duhet të jetë i vlefshëm - ai duhet të vlerësojë atë që dëshirojmë ta vlerësojmë.
- Vlerësimi duhet të jetë i besueshëm - vlerësuesit e ndryshëm dhe

në kohë të ndryshme duhet të japin rezultat të qëndrueshëm (pra, vlerësim me të njëjtin standard).

- Vlerësimi duhet të jetë i barabartë - instrumentet e vlerësimit duhet të jenë të njëjta dhe proceset të jenë të drejta.
- Vlerësimi duhet të jetë i paanshëm - pra nuk duhet favorizuar individit apo grupit.
- Vlerësimi duhet të bëhet në kohën e duhur.

Shpesh, orët e vlerësimit të TIK-ut realizohen në laboratorët e informatikës, ku nxënësit ulen në grupe nëpër kompjutera. Mësuesi mund ta shfrytëzojë këtë situatë në favor të vlerësimit, duke u dhënë nxënësve detyra sipas grupeve. Secili nxënës bën një pjesë të detyrës, nxënësit vlerësohen në bazë të kontributit individual ose si mesatare e punës në grup, kjo realizohet në varësi të detyrës së dhënë dhe mundësisë që ofron ajo. Në këtë mënyrë vlerësimi është i saktë dhe real.

Si realizohet vlerësimi i brendshëm ?

- Është i përditshëm dhe i vazhdueshëm ;
- me anë të kërkesave që bëhen në klasë;
- me anë të detyrave të shtëpisë;
- me anë të aktivizimit në klasë gjatë shtjellimit të materialit;
- me anë të aktivizimit të punës në grup;
- me anë të testeve kohëshkurtra – përvetësim i njësisë mësimore;
- me kuice (lojra me shumë pyetje e përgjigje). Shoqërohet edhe me vënien e notave etj.

Ku duhet të bëhet kujdes gjatë procesit të vlerësimit të brendshëm ?

- Humbja e përkohshme apo e pjesshme e objektivave të vlerësimit.
- Pamjaftueshmëria e treguesve që përdoren për të bërë vlerësimin.
- Duhet t'i kushtohet sa më shumë kujdes përvetësimit të koncepteve.
- Nuk ka rëndësi shumë riprodhimi i vërtetimeve dhe zbatimeve, por kuptimi i thelbit të koncepteve si model i punës së pavarur.
- Momentet kur duhet të përdoret teksti shkollor.
- Momentet kur duhet të përdoren mjetet e punës.
- Të mos ketë shumë riprodhim gojor të materialit të mësimin.

- Të mos humbasë kontakti nxënës - mësuesdhënës.
- Të mos mbingarkohet me rregulla e formula.